

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVI i botimit, nr. 184, Shkurt 2019

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

SHQIPJA NË DITËN NDËRKOMBËTARE TË GJUHËS AMTARE 3

21 shkurti është Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare, që kremtohet në të gjitha vendet e botës. Qëllimi i caktimit nga UNESCO-ja të kësaj dite si dita e gjuhës amtare ka qenë vlerësimi i gjuhës si mjeti më i rëndësishëm për ruajtjen dhe trashëgimin e kulturës së çdo populli dhe i nevojës për të nxitur lëvrimin e gjuhëve amtare të popujve dhe të etnive dhe të popujve të botës, të cilat janë pjesë e thesarit kulturor të njerëzimit.



MYFTAR ELEZ CUBI, NDERI I QARKUT SHKODËR

Me datën 9 shkurt 2019, në mjediset e Hotel "ROZAFI", nga Shoqata Atdhetare "Malësia" në bashkëpunim me Qendrën e Kulturës së Këshillit të Qarkut u organizua ...



2

SHTATË SHALJANËT

Historia, trimëria dhe heroizmi i shtatë shaljanëve në Kështjellën e drës tashmë është ngurtësuar në faqet e historisë së Shalës, Dukagjinit dhe më gjerë. Nuk kemi mundur të konsultojmë një dokument origjinal mbi këtë ngjarje sa trimërie dhe po aq patriotike në mbrojtje të identitetit tonë krahinor dhe kombëtar, sepse koha ishte e tillë si nga thellësia, por edhe për nga vepra e tyre kundër pushtimit osman që nuk u interesonte publikimi i saj, prandaj ka mbetur në heshtje (e fshehur) nga ata që kishin mundësi që ta bënin një gjë të tillë. Por veprat e mëdha kurrë nuk mund të mbetën të fshehta, sepse populli ka gjetur forma, në të gjitha kohët, për ti ruajtur në kujtesën historike e krahinës dhe e vendit. Një faktor shumë i fuqishëm ka qenë kënga dhe folklori që ka bërë të ruhen shumë akte e veprime madhore, mençurie e trimërie.

4

TIRANA OSE KRYEQYTETI ME HISTORI TË FALSIFIKUAR

Emri i kryeqytetit të Shqipërisë, Tiranë, vijon të interpretohet me shtrembërime e gabime të mëdha të realitet historik.

Për fat të keq edhe në literaturën evropiane e më andej deri në periudhën e tanishme qytetin e Tiranës e njeh si një qytet që qenka themeluar nga një shqiptar i turqizuar i quajtur Sulejman Pash Bargjini prej Mulleti.

Si depërtoi në literaturën evropiane ky version historik për themelimin e Tiranës?.

Edith Durham, pasi njihet me historinë e këtij qyteti, që ia thanë vendasit thotë: "Tirana është themeluar me 1600 nga një bej i pasur, i cili i vuri këtë emër në kujtim të një fitoreje të turqve ..."


5

FREDERIK RRESHPJA, TEK PORTA E VDEKJES 15

- ME RASTIN E
PËRVJETORIT TË VDEKJES
SË MJESHTRIT TË MADH,
FREDERIK RRESHPJA -
Moikom Zeqo

Në mëngjesin e funeralit të Frederik Rreshpes, u nisa herët nga Tirana për të qenë i pranishëm në funeralin e mikut tim.

Kishte ardhur nga Durrësi me makinë vëllai im i vogël që quhet Frederik, i cili e njihte shumë mirë Frederikun poet, kishte kujtime me të, sepse kishim qenë bashkë shumë herë.



CURRAJ i EPËR VETËZBULOI VIRGJËRINË DHE HIRET E VETA RREZATUESE ALPINE

Curraj i Epër, vëlla siamez, i lidhur me një kërbizë me Thethin, shpinë për shpinë me Valbonën, ndërsa më Vermoshin i bashkon e njëjta telepati natyrore. Bukuroshi i fjetur i bjeshkëve tona, gjendet në vazhdimin fundor të pellgut të Nikaj Merturit, i rrethuar vrullshëm me male gjigante, mbi 2000m, ...

12

MYFTAR ELEZ CUBI, NDERI I QARKUT SHKODËR

Me datën 9 shkurt 2019, në mjediset e Hotel "ROZAFÄ", nga Shoqata Atdhetare "Malësia" në bashkëpunim me Qendrën e Kulturës së Këshillit të Qarkut u organizua ceremonia e dorëzimit të titullit të nderit, piktorit e pedagogut në Akademinë e Arteve, zotit Myftar Cubi.

Në këtë ceremoni ishin prezent Kryetarja e Këshillit të Qarkut, zonja Gerta Bardeli, këshilltar të bashkisë Malësia e Madhe dhe të Qarkut Shkodër, koleg të Myftarit, përfaqësues të shoqatave të ndryshme në Shkodrës e të tjerë.

Ceremoninë e hapi kryetari i kësaj shoqate, Ilmi Kurti, i cili pasi bëri prezantimin e kësaj ceremonie, ju dha fjalën disa pjesëmarrësve.

Me këtë rast, folën mjaft koleg të Myftarit për kontributin e tij në fushën e artit të pikturës, në veçanti në atë të mozaikut dhe që ka bërë emër në arenën ndërkombëtare deri në SHBA, duke nderuar Shqipërinë, por në veçanti Qarkun e Shkodrës.

Pastaj e mori fjalën kryetarja e Këshillit të Qarkut, zonja Bardeli, e cila pasi foli për vlerat e kontributin e zotit Myftar, i dorëzoi titullin "Nderi i Qarkut Shkodër".

Me këtë rast, përshëndeti dhe zoti Ndue Sanaj, kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", i cili në mes të tjerave theksoj: "Të nderuarin Myftarin e njoha gjatë hulumtimit e studimit për "Gjurajt". Këtë burrë e takova në studion e punës së tij. Ky, me thjeshtësinë e komunikimin e tij shumë njerëzor, mua dhe Arben Gjurarj na dha shumë kuraja për të vijuar këtë punë pa u ndalur, se është e para punë, që i bëhet e këtij lloji për Gjurarjt dhe nesër kushdo që mund ta vijojë më tej këtë studim, nuk e fillon nga e para. Ju lumtë!. Ky personalitet, ky artist i fushës së pikturës e në veçanti të mozaikut, meriton nderimin, që i jep Këshilli i Qarkut, këtij burri të Malësisë. Me këtë rast, falënderoj anëtarët e Këshillit të Qarkut Shkodër e në veçanti zonjën Gerta, që së bashku me bashkëpunëtorët e saj, vlerësojnë propozimet që i bëhen nga shoqëria civile! ".

Me këtë rast u shpërndan dhe tituj nderi, "Ambasador të Paqes" si Piktorit Myftar Cubi, Shtjefen Ivezaj dhe të tjerëve.

Disa të dhëna për punën e profesor dr. Myftar Cubi:

*Myftar Elez Cubi, lindur me 12 prill 1954, në Koplík të Sipërm. Ka përfunduar studimet e larta, në Akademinë e Arteve të Bukura. Në vitin 2009-2010 merr titullin "Master në Pikturë", në Universitetin e Prishtinës. Është pedagog në Akademinë e Arteve të Bukura. Ai ka një eksperiencë të gjerë në punën e tij, si piktor. Ka marrë pjesë në disa ekspozita në bashkësi, por edhe ka hapur disa ekspozita personale brenda vendit dhe në shume vende të tjera në Evropë e në SHBA.

Ato janë:

- Në vitin 1989 -pjesëmarrës në ekspozitën kombëtare të 45 vjetorit të Çlirimit, GKA;
- 1993-Ekspozitë për Greqinë Muzeu Historik Kombëtare; 1993-Ekspozitë personale në Athin



Zoti Myftar Cubi i nderuar me titullin "Nderi i Qarkut Shkodër" dhe "Ambasador i Paqes"

- | | |
|---|---|
| Galeria "Pilarinos" Sofokleos 7-9; | Cuovadis Tiranë; |
| • 1994-Ekspozitë personale në Athin; | • 2002-Ekspozitë personale, në Vjen, Austri; |
| • 1995-Pjesëmarrës në ekspozitën "Onufri" GKA Tiranë; | • 2004-Ekspozitë personale GKA Tiranë; |
| • 1996- Pjesëmarrës në ekspozitën Onufri GKA Tiranë; | • 2005-Ekspozitë kolektive, GKA Tiranë; |
| • 1999-Ekspozitë kolektive Paris Francë; | • 2006-Pjesëmarrës në ekspozitën 600 vjetarit të Gjergj Kastriotit, GKA Tiranë; 2006-Pjesëmarrës në Ekspo Art Në York SHBA; |
| • 2001-Ekspozitë personale Zvicër; | |
| 2002-Ekspozitë personale | |



Zoti Shtjefen Ivezaj, i nderuar me titullin "Ambasador Paqe"

- 2007-Ekspozitë kolektive në Ulqin; 2007-Ekspozitë kolektive Tuz, Podgoricë;
- 2009-Dhuratë Papa Benediktit XVI, Vatikan;
- 2012-Ekspozitë personale, në 100 vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë; 2012-Portret Ish Presidentit SHBA-se Bill Klinton, që ndodhet në zyrën e tij; 2012-Portreti i ish Mbretit të Shqipërisë Ahmet Zogu;
- 2015-Dorëzohet në mënyrë ceremoniale figura e Nen Terezës, Komitetit Olimpik Ndërkombëtare, në Lozan Zvicër; 2015-Portreti i Kancelares Gjermane, Znj. Merkel, e cila ndodhet në zyrën e saj; 2015-Portreti i Kryetarit të Bashkisë së Londrës, z. Boris Jonsen.

Urime piktori Myftar Cubi!
Redaksia

SHQIPJA NË DITËN NDËRKOMBËTARE TË GJUHËS AMTARE

nga Prof. dr. Rami Memushaj

21 shkurti është Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare, që kremtohet në të gjitha vendet e botës. Qëllimi i caktimit nga UNESCO-ja të kësaj dite si dita e gjuhës amtare ka qenë vlerësimi i gjuhës si mjeti më i rëndësishëm për ruajtjen dhe trashëgimin e kulturës së çdo populli dhe i nevojës për të nxitur lëvrimin e gjuhëve amtare të popujve dhe të etnive dhe të popujve të botës, të cilat janë pjesë e thesarit kulturor të njerëzimit.

Duke u ndalur këtë ditë te gjuha shqipe, si gjuha amtare e shqiptarëve kudo ku ata jetojnë, vërejmë me kënaqësi se statusi i saj këta 100 vjetët e fundit ka ardhur duke u rritur. Nga gjuhë e ndaluar nën pushtimin otoman, me shpalljen e Pavarësisë më

maqedonas i ligjit për gjuhën shqipe, kjo u njoh si gjuhë zyrtare rajonale, pra fitoi status zyrtar, po jo me të njëjtin status me maqedonishten, sikundër ia kishte njohur kushtetuta jugosllave. Përtej këtyre trevave, në Mal të Zi shqipja ruan statusin që ka pasur, si gjuhë rajonale e përkrahur nga shteti; në Greqi për popullsinë e trevave shqiptare brenda kufijve të këtij shteti dhe për arbërorët shqipja është gjuhë e papërkrahur nga shteti, por jo e ndaluar të mësohet nga fëmijët e emigrantëve; në Itali shqipja është gjuhë e përkrahur e pakicës arbëreshe dhe e lejuar të mësohet nga fëmijët e emigrantëve shqiptarë, ashtu si në gjithë Europën; kurse në Turqi shqipja nuk mësohet nga fëmijët e emigrantëve.

Gjuha shqipe ka përparuar shumë këta njëqind vjet edhe për sa i përket

në të gjithë veprimtarinë ligjëruese të shkruar e të folur. Në trojet shqiptare të ish-Jugosllavisë Konsulta u vuri detyrë shkollës enteve botuese, redaksive e gazetave dhe administratës zbatimin e normën letrare; kurse në Shqipëri, zbatimin i normave të gjuhës letrare nga shkolla, entet botuese dhe administrata shtetërore u bë i detyrueshëm me një vendim të vitit 1978 të Këshillit të Ministrave.

Pas viteve '90, me përmbysjen e sistemeve politike një partiake dhe kalimin në pluralizëm, u vu re një rënie e theksuar e kujdesit për gjuhën nga të gjithë, nga shteti e shoqëria, që u pasua edhe me kontestime të gjuhës letrare e me përpjekje për krijimin e gjuhëve të reja letrare. Në praktikën e ligjërimit të shkruar e të folur, për fat të keq, kjo

panevojshme, madje i fjalëve “kopile”, si realizoj, akses e aksesoj, tentoj, mesazh e të tjera, të cilat po e drunjëzojnë e po e venitin gjuhën, duke u zënë vendin dhjetëra fjalëve të bukura shqipe që përdoren në kontekste të ndryshme sintaksore; edhe në fushën e drejtshkrimit mospërdorimi i shkronjave ë dhe ç është tregues i injorancës kompjuterike, po edhe mungesë e respektit për alfabetin tonë, për shkronjat e të cilat është derdhur gjak. Në televizione po sundojnë modele aksentologjike të huaja, duke i theksuar fjalët e thjeshta e kompozitat në rrokjen e parë si në anglishte, kur modeli theksor i shqipes kërkon theksimin fundor të fjalës, veçanërisht të fjalëve të përbëra, në të cilat pa asnjë përjashtim theksohet përbërësi i dytë. Ky model i huaj theksimi



28 Nëntor 1912, ajo u bë gjuhë zyrtare e shtetit shqiptar, ndonëse mbeti gjuhë e ndaluar për pjesën tjetër të kombit që u bënë me dhunë pjesë e shtetit grek dhe e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene. Kjo gjendje u përmirësua pas Luftës së Dytë Botërore, kur shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi fituan të drejtën e shkollimit në gjuhën amtare dhe hapën shkolla të të gjitha niveleve deri te Universiteti i Prishtinës dhe katedra e gjuhës shqipe në Universitetin e Shkupit.

Me kushtetutën jugosllave të vitit 1974, shqipja në këto troje u ngjit në shkallën e gjuhës zyrtare rajonale në Kosovë dhe të gjuhës zyrtare paralele në Maqedoni. Këtë fillim shekullit, me shpalljen e Kosovës shtet i pavarur, shqipja u bë gjuhë zyrtare kryesore, ndërsa në Maqedoni që nga vitet '80 të shekullit të kaluar e deri një vit më parë, shqipja ra në statusin e gjuhës rajonale të papërkrahur nga shteti. Po vitin e kaluar, me miratimin nga parlamenti

shkallës së përpunimit të saj. Nga gjuhë me disa variante letrare e dy gjuhë zyrtare (toskërishtja në Shqipëri, gegërishtja në trojet shqiptare në ish-Jugosllavi), prej vitit 1972 ajo është ngritur në shkallën e gjuhës letrare kombëtare, të pranuar nga të gjitha pjesët e kombit. Ishte Konsulta e Prishtinës e prillit 1968 ajo që hodhi hapin e madh të bashkimit gjuhësor, kur intelektualët shqiptarë të atjeshëm, të udhëhequr nga motoja “një komb – një gjuhë letrare”, shpallën se shqiptarët në Jugosllavi pranonin “si gjuhë të vetën letrare gjuhën letrare të vendit mëmë”. Kongresi i Drejtshkrimit e sanksionoi këtë vendim të tyrin, duke shënuar në këtë mënyrë fundin e periudhës kur shqipja shkruhej në disa variante dhe fillimin e jetës kombëtare shqipes letrare. Periudha nga Kongresi i Drejtshkrimit e deri më 1990 vlerësohet nga të gjithë si periudha e përpjekjeve për zotërimin dhe përdorimin e normave të gjuhës letrare

gjendje vijon edhe në ditët tona, kur vijon mungesa e pafalshme e kujdesit të shtetit për gjuhën, ndonëse kushtetutat e të dy shteteve shqiptare e shpallin mbrojtjen e gjuhës si detyrim shtetëror. Sa pak e mbrojmë gjuhën shqipe, kjo duket po ta krahasojmë gjendjen në këtë pikë me vendet fqinje. Maqedonia e Veriut ka një ligj për gjuhën, i cili parashikon sanksione të rrepta për shkelësit e tij – institucione, redaksi apo ente botuese. Kurse as Shqipëria dhe as Kosova nuk kanë ende një ligj për gjuhën, ndonëse projektligji përkatës është depozituar prej kohësh në të dy kuvendet.

Si pasojë e mungesës së kujdesit shtetëror për gjuhën, në botimet, në gazetave e revistat, në televizionet dhe në dokumentacionin zyrtar vërehen shkelje të pafalshme të normave të gjuhës letrare. Më e dukshme kjo dukuri e shëmtuar është në fushën e fjalorit, ku vërehet një vërshim i fjalëve të huaja të

ka prishur edhe melodinë dhe metrikën e frazës, që nuk tingëllon më si shqip, po si një surrogat shqip-anglisht-italisht.

Sot, në Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, është rasti t'u drejtohem shkollës, shtypit dhe të gjithë atyre që janë përfshirë në ligjërimin publik, me thirrjen që të tregojnë respekt për gjuhën tonë, e cila është tipari i vetëm që na dallon prej të tjerëve dhe na bashkon ne shqiptarët në një komb. Thirrja jonë i drejtohet edhe shtetit që të kujdeset për gjuhën, në radhë të parë, duke miratuar ligjin përkatës, i cili do t'u jepte zgjidhje shumë problemeve, duke krijuar një mjedis të pastër nga ndotjet gjuhësore e shkeljet e normave të gjuhës letrare. Dhe deri në miratimin e këtij ligji jemi të mendimit që shteti të kthejë në fuqi vendimin e Këshillit të Ministrave të vitit 1978.

Marrë nga gazeta “DITA”,
21 shkurt 2019

SHTATË SHALJANËT

- mendime -

Historia, trimëria dhe heroizmi i shtatë shaljanëve në Kështjellën e Shkodrës tashmë është ngurtësuar në faqet e historisë së Shalës, Dukagjinit dhe më gjerë. Nuk kemi mundur të konsultojmë një dokument original mbi këtë ngjarje sa trimërie dhe po aq patriotike në mbrojtje të identitetit tonë krahinor dhe kombëtar, sepse koha ishte e tillë si nga thellësia, por edhe për nga vepra e tyre kundër pushtimit osman që nuk u interesonte publikimi i saj, prandaj ka mbetur në heshtje (e fshehur) nga ata që kishin mundësi që ta bënin një gjë të tillë. Por veprat e mëdha kurrë nuk mund të mbetën të fshehta, sepse populli ka gjetur forma, në të gjitha kohët, për ti ruajtur në kujtesën historike e krahinës dhe e vendit. Një faktor shumë i fuqishëm ka qenë kënga dhe folklori që ka bërë të ruhen shumë akte e veprime madhore, mençurie e trimërie. Kështu ndodhi edhe me heroizmin e shtatë shaljanëve. Këtë përpjekje, ndonëse kohë të vështira, nën pushtimin e egër osman, pa shkollë e mundësi komunikimi, e bëri të mundur gdhendjen e saj në faqet e historisë, kënga e cila kaloi gojë në gojë, nga brezi në brez dhe erdhi në ditët tona mjaft e fuqishme. Në kohën kur nuk kishte shkollë, kur njerëzit nuk dinin shkrim e këndim shqip, këngët e gojëdhënat ishin e vetmja mënyrë për të përjetësuar akte trimërie, vepra të mençura, vepra të mëdha. Në ato kohë, veçanërisht në krahinën tonë, por edhe shumë më gjerë, asnjë këngë nuk shkruhej që të mësohej, por mësohej nëpërmes dëgjimit, sepse nuk dinin shkrim e këndim shqip. Mësoheshin, duke i dëgjuar dhe mbeteshin në mendjen e njerëzve, ato këngë që preknin "telat" e zemrës së njerëzve, që bënin fjalë për ngjarje të vërteta dhe jo të sajuara.

Edhe unë e kam dëgjuar këngën që bën fjalë për gjashtë shaljanë e një shoshjan që ranë në Kështjellën e Shkodrës në atë kohë, të kënduar nga një këngëtar, të cilin unë e pëlqej dhe e respektoj shumë. Më ka bërë përshtypje, se si paska ndodhur i shoshjani me ta, kur që të gjitha kanë qenë shaljanë, madje, kanë qenë të gjithë Pecnikaj. Edhe kjo është interesante, por ndoshta ishin përgatitur për të mbrojtur, pse jo edhe për të vdekur me prijësit e fisit të tyre, që i kishte thirrur Pasha i Shkodrës, sepse kishte ndodhur ndonjë herë ndër fise të tjera, që të vriteshin me pabesi.

Unë kam mundur të lexoj dhe të kem në arkivin tim disa këngë për këtë ngjarje, që zënë fill që me botimin nga Thimi Mitko në "Bleta Shqiptare" në vitin 1878 në Aleksandri. Në fund të faqes bëhet edhe një sqarim për kohën kur ka ndodhur kjo ngjarje, për të cilën bën fjalë kënga. Është e shkurtër dhe nuk përmendë asnjë shoshjan. Po kështu kam lexuar dhe e kam

një këngë të botuar në "Hylli i Dritës" në vitin 1934. Edhe këtu nuk bëhet fjalë për asnjë pjesëtar nga Shoshi. Edhe në dramën "Shtatë Shaljanët", e cila është shfaqur që nga fundi i viteve '50 nuk ka një pohim të tillë, po kështu edhe disa të



Moment nga shfaqja e dramës "Shtatë Shaljanët" nga trupa e Teatrit "Migjeni", në Shkodër, në vitin 1958, e shkruar nga Artisti i Popullit, Ndrek Luca

tjera të publikuara në Visaret e Kombit, pa u ndalur në këngët e kënduara në gjysmën e dytë të shekullit të XX e në vijim.

Për mua nuk është aspak e rëndësishme nëse qe apo jo një i shoshjanë me shaljanët që luftuan në Kështjellën e Shkodrës në

afërmit dhe bashkëkrahinarët, e për më tepër që është një ngjarje shumë e veçantë në historinë e krahinës dhe Shkodrës, për të cilën duhet të krenohemi të gjithë.

Unë mendoj, se nuk është e shëndetshme që të bëhen përpjekje për të ndarë Shalën e Shoshin, për të nxitur kundërshti të panevojshme, për të vepruar ku me "kujdes" apo edhe më hapur, që të mund të shkaktojnë një farë zemërimi,

tendence që lë shteg për keqinterpretime, ndarje midis krahinave e zonave me të njëjtën prejardhje me gjak të përbashkët, me doke e zakone të përbashkëta, me lidhje të shumta martesore me njëri - tjetrin, me nipa e mbesa të shumtë në të

por në tërësi të gjithë Dukagjinit, i bashkojnë shumë e më shumë fije e lidhje, se sa i ndajnë. Nuk kemi ndryshime në doke e zakone, në të folurën e veshjen, në mënyrën e të jetuarit, në mënyrën e sjelljes, në dasmë e mort, në gëzime dhe hidhërim, prandaj jemi një zonë, sepse jemi krahina me të përbashkëta e veta të vendosur në territor të përbashkët e të trashëguara shumë gjatë, me shekuj.

Personalisht, në të gjithë punën, modeste, që kam pasur mundësi të shkruaj e të bëj për Dukagjinit, në asnjë rast nuk jam përpjekur që të vë kufi ndarjeje, në veçanti midis Shalës e Shoshit. Ata që shkruajnë, që këndojnë, që veprojnë në punë, në politikë, në marrëdhëniet shoqërore e miqësore, është mirë të jenë shumë dashamirës, shumë bashkëpunues. Që të jesh bashkëpunues nuk do të thotë, që tjetri të pranojë apo të bëjnë atë çfarë them unë, por as të pranojë e të bëjë unë atë çfarë thotë tjetri pa një diskutim, analizë e arsyetim, atëherë është e mundur. Dëshira për të imponuar të tilla mendime e veprime nuk është bashkëpunim, është urdhër, është tutelë.

Po shkruhen e po këndohen shumë këngë. Folklori ka marrë një vrull jo të vogël. Kjo është shumë e mirë, sepse nga të pasurit shumë nuk ka gjë të keqe. Por, mendoj, se duhet të ruhem nga të pavërtetat. Në kohën e sotme, kur shkrimi e këndimi janë shtrirë kudo, kur teknologjia e informacionit dhe komunikimit ka arritur maja të papara më parë, kur rrjetet sociale janë të shumta e kanë mundësi kushdo të futet dhe rrugëtojnë në to. Pra, nuk është më kënga e vetmja që përjeton një ngjarje, një veprimtari, një njeri, një grup njerëzish. Tregues i qëndrueshmërisë së një këngë është përvetësimi që i bën populli asaj këngë. Këngët e mira për veprimtari të mira mësohen shumë shpejt nga populli dhe mbahen në kujtesën e tij. Ky është tregues i vlerave.

E shënova edhe pak më lart, se këngët, në kohën kur nuk kishte shkrim e këndim shqip masiv, kanë qenë dhe mbeten akoma, si një e dhënë shumë e rëndësishme dokumentare, historike, kulturore, etnografike, e të tjera, sepse ka fiksuar vlera të veçanta. Nuk duhet të ndodhi mundësia, që tu largohemi këngëve folklorike si faktor i rëndësishëm i burimit, për të dokumentuar apo ilustruar një veprimtari, një heroizëm, një dokumentar, një ngjarje, që siç thotë populli "ka ba për kangë". Nuk e dëmton aspak këngën, as imazhin e autorit të shkrimit të këngës, një konsultim me miq, historian, etnolog, intelektual, koleg, muzikantë, e të tjerë, kur përgatitet një këngë, që nga fjalët deri te melodia, orkestrimi, interpretimi e grupi që e shoqëron.

Të mos harrojmë, se në shumë e shumë raste nuk mbetet ajo që fiton, por fiton ajo që mbetet.

Nga Luigj SHYTI



Moment nga shfaqja e dramës "Shtatë Shaljanët" nga trupa e Teatrit "Skampa" të Elbasanit

vitin 1816, që përkon më sundimin e Ibarhim Pashë Bushatit. Edhe po të ketë qenë, aspak nuk ja ulë vlerën asaj ngjarje.

Shtatë shaljanët trima ishin, Vatë Nika, Ndre Pepa, Marash Pali, Deli Pjetra, Ndre Koltona, Hasan Pepa, Çun Luci. Këta tashmë janë në kujtesën historike të krahinës dhe më gjerë. Atëherë kush nga këta nuk ka qenë në saraj dhe ka qenë i shoshjani. Kur e kemi afër pse të shkojmë e ta kërkojmë larg deri në Serbi që na dalka se ishin 17 vetë?

Ngjarja rreth 202 vjet ka, e cila ka ndodhur, dhe për veprën e tyre nuk është shumë që të harrohet, nga pasardhësit të

dy anët, e të tjera.

Shala e Shoshi janë dy krahë të fuqishëm të një trupi, të cilët as "shpatulla nuk i ndanë". Shala e Shoshi nuk kanë lejuar as pranuar që të ndahen asnjëherë, nuk kanë lejuar askënd që tu futet në mes. Kanë qenë kohë të vështira dhe i kanë përballuar me urtësi e trimëri, e korës së sodit nuk është mirë as tu shkojnë ndër mend e aq më pak për të tentuar të krijojnë plasaritje a përçarje. Askush nuk duhet të tërheqë shumë prej vetes, ashtu si askush nuk duhet të shtyjë shumë kojshinë, vëllain, bashkëkrahinarin në shekuj, në të mirë dhe në të vështirë. Shalën e Shoshin,

TIRANA OSE KRYEQYTETI ME HISTORI TË FALSIFIKUAR

(ME RASTIN E 99 VJETORIT TË PROPOZIMIT PËR SHPALLJE KRYEQYTET)

Emri i kryeqytetit të Shqipërisë, Tiranë, vijon të interpretohet me shtrembërime e gabime të mëdha të realitet historik.

Për fat të keq edhe në literaturën evropiane e më andej deri në periudhën e tanishme qytetin e Tiranës e njeh si një qytet që qenka themeluar nga një shqiptar i turqizuar i quajtur Sulejman Pash Bargjini prej Mulleti.

Si depërtoi në literaturën evropiane ky version historik për themelimin e Tiranës?

Edith Durham, pasi njihet me historinë e këtij qyteti, që ia thanë vendasit thotë: "Tirana është themeluar me 1 600 nga një bej i pasur, i cili i vuri këtë emër për kujtim të një fitoreje të turqve në Teheran të Persisë". (E. Durham "Brenja e Ballkanit," Tirane, 1991, fq. 92).

Sipas kësaj thënie, emri Tiranë na del i ardhur prej Irani si derivat i këtij qyteti, gjë që është absurde dhe plotësisht e pa vërtetë. I njëjti shpjegim është shkruar edhe te "Enciklopedia Evropiane", botimi italisht, ku thuhet: "Tirane da Teheran, nome che le diede, quando la fondo al principio del secolo XVII, il generale turco Suleyman Pascià..." (Tiranë prej Teheran, emën që thuhet i është venë, kur e themeloi princi i shekullit XVII, gjenerali turk Sulejman Pasha) ("Albania" botuar në "Enciclopedia dei popoli d'Europa", Enciklopedia e popujve të Evropës, 1965 fq. 390)

Gjithashtu, deri në ditët e sotme i mëshohet një legjende tjetër, sikur në bregun e Lanës po "tirez ranë", si me thanë po hedh ranë, gjë që edhe kjo nuk ka asnjë bazë shkencore. Pa themel më duket edhe interpretimi tjetër, sikur ky vend u popullua prej të ardhurve nga malet e spjegohet me "të ranët", të zbriturit në fushë.

Së fundi, është hedhur edhe një ide tjetër, që toponimi Tiranë vjen prej një kështjelle me emrin Trikan, të përmendur nga Prokop (shekulli VI), që shkruesit e tanishëm e lidhin me Tyros, që në greqisht do të thotë bylmet (Theranda), e cila mund të ketë një lidhje me toponimin Tiranë.

Le ti japim disa ide më të qarta këtij toponimi duke u nis nga literatura e jonë dhe ajo botërore.

E quajmë të pamundur që emri Tiranë të jetë pagëzuar nga S. P. Bargjini. Pra, të jetë huazuar prej emrit Teheran, sepse Tirana ka një histori shumë më të lashtë. Në qoftë se është e vërtetë se jeniçeri S. Bargjini u kthye në shekullin e XVII në vendlindjen e tij si pasha turk dhe bëri disa ndërtime, ky fakt nuk dëshmon asgjë për themelimin e qytetit. Emrin Tiranë e përmendë Marin Barleti mbi 14 herë te libri "Historia e Skënderbeut" (Infobotues, Tirane, 2005) qysh në shekullin e XV duke evidentuar faktin

se kishte dy Tirana; Tirana e Madhe dhe Tirana e Vogël. (Të shikohen faqet 28, 32, 47, 214, 217, 220, 231, 234, 250, ...e deri te 480.).

Po kështu edhe F. S. Noli në veprën e tij "Historia e Skënderbeut", shkruan: "Fortesat e Gjon Kastriotit qenë Kruja, e cila ishte kryeqyteti i principatës, Petrella afër Tiranës, Petralba..." (Noli vep. 4, Akademia e shkencave, Instituti i Gjuhësisë e Letërsisë, Tiranë 1989, fq. 69). Në faqen 109 të po kësaj vepre shkruhet: "Skënderbeu ... sapo mori lajmin që Ali Pasha po afrohej, mblodhi ushtrinë e doli në fushë, pranë Kasharit, një fshati afër Tiranës Vogël..." dhe në shpjegim Noli vazhdon: "Tirana e vogël ishte afër Krujës. Në këtë vend lindi Justiniani, perandori roman i Bizantit, i cili ndërtoi afro 20 kishë, në Shqipëri të Mesme" (po aty fq. 107).

Sipas Biemmi, cituar nga Kristo Frashri, shkruan: "Ushtria turke e tërhoqi rrethimin në Fushën e Tiranës, tetë milje larg Krujës..." dhe Biemi vijon, se Skënderbeu kaloi në rivistë ushtrinë e tij pranë Kasharit, fshat i Tiranës së Vogël. "Presso Cassar vilagggio di Tirana minore". (K. Frashri "Historia e Tiranës" vol. I, Toena, fq. 63)

paralen e quajtur "tyrannos" dhe "Tiranno" (që vertetësisht ka prejardhje ilire, shënimi im) dhe i shkon përshtatet thjeshtë me fjalën "signora" apo "zonjë".

Kjo hyjni është nderuar qysh 480 vjet para Krishtit dhe ka pas një përhapje të jashtëzakonshme në Iliri e gjetkë duke krijuar edhe kult. Këtë e vërtetojnë edhe shumica e kishave me këtë emër. Jo rastësisht një e teta e kishave të vendit tonë kanë marrë emrin e Venerandes, që në popull është e Shëna e Premtes (Prendes) e deri te emri i përgjithshëm evropian e më andej Ana (Anna).

Po kështu, këtë emër e gëzon edhe dita e pestë e javës (venerdì, dita e venerandes te latinet) dhe e premtë (e prende, gegnisht) te ne shqiptarët. Tujan ose Turan është hyjni e dashurisë dhe e pjellorisë dhe ishte e martuar me Laran, çuditërisht me një afrimitet me Lana (lumi që përshkon Tiranën).

Duke u njohur me toponimet dhe objektet mbrojtëse dhe të kultit që mbështjellin Tiranën dhe rrethojat dalim në përfundim, se ky qytet e meriton plotësisht emrin "Zonjë" (sinjora) dhe moshë e kësaj zonje është mbi dymijë vjeçare.

"Përveç vendit të begatë fushor të

zyrtare të kësaj feje. Kështu kemi fshatrat Shën Pal, Shën Mëri, Shën Gjergj, Shën Gjin, Përroi i Shën Mëhillit, qafë Kishë, Shën Ndoi i madh dhe Shën Ndoi i Vogël (dy maja shkëmbinjsh), qafë Shmark, Fushë Kishë, kisha Shalqize (Lunder) si dhe mozaiku i Tiranës me vlera të mëdha historiko – arkeologjike në Shqipëri e më andej. Si më e përmendura kishë është ajo e Shën Mërisë në Brar, që datohet e vitit 1 201. Në këtë kishë gjatë gërmimeve është gjetur një varr me pesë harqe, që i takon pjesëtarëve të një familje me një epitaf dhe mbiemrin Sguro. Të pesë harqet kanë nga një kryq dhe përfaqësojnë pesë të vdekurit e familjes, të cilën e sqaron edhe epitafi në greqisht që thotë: "Kujto o Zot shërbëtorin tënd sevastin Mihal Sguron me bashkëshorten e fëmijët!" Këtu ndodhen edhe 8 varre të tjerë të besimit katolikë dhe sipas specialisteve Tirana ka vijuar me këtë rit fetar deri në shekullin e XV, kur fillon konvertimi i banorëve të saj në fenë tjetër.

Mësuam se ky objekt i një rëndësie të veçantë u shkatërrua këtë vit nga eskavatorët gjatë punimeve ndërtuese.

Pukevil na bën të ditur se "Justiniani rindërtoi Tyranen, Aulonon, Musionin" dhe me poshtë në shpjegimin që u bën



Në rranzë të Dajtit, në anën e majtë të lumit dhe Grykës së Tujanit ngrihet një kështjelle, me të njëjtin emër, Kështjella e Tujanit, që sipas studiuesve i takon shekullit të IV para Krishtit dhe ishte si një portë hyrëse për korridorin Durrës - Tiranë - Dibër.

Duke shtjelluar toponimin Tujan na çon deri në kohën e etruskëve dhe sipas "Dizionario Illustrato della Civiltà Etrusca" të Mauro Cristofani, fq. 304 shkruhet: "Është një hyjni etruske e barabartë me Afroditën greke e Venere romake. Mund të ketë edhe një rrënjë

lënë nga një gji deti prehistorik, Tiranën e rrethojnë mbi dymbëdhjetë kështjella mbrojtëse si, kështjella e Ndroqit, e Petrelës, e Tujanit, e Prezës, e Lalmit, e Dorësit, e Dajtit, e Presqopit, e Shën Gjergjit, e Berzhitës, e Priskës, e Tiranës e të tjera, te cilat i takojnë shekullit VI të kohës Justinianit I dhe deri te kështjella e Krujës, e cila ndodhet përball Tiranës së Vogël" - thotë Barleti).

Tirana dhe rrethinat e saj janë të mbushur me emra shenjtorësh të krishterë dhe bëhet dëshmitare e përfaqimit të fesë së Krishtit menjëherë pas shpalljes

thotë "Tyрана – Turkana, fortesë në Epirin e Ri" (Pukevil, "Udhëtime", vëll. 1, fq. 373)

Në testamentin, që Gjon Muzaka u le të bijve, në vitin 1510 thotë: "Karl Topia ishte zot i dy Shkurive, i Fizines dhe Plevishtit në Taransen e Vogël, Kanabi, Forka..." (pra Tirana e Vogël, Krraba dhe Farka). (Emanuele Polito, "I Musachi di Berat" Muzakajt e Beratit, Paris – Lecce – Pergola Mansavium, 1996, fq 126).

Në relacionin e vitit 1570, një autor anonim venedikas shkruan: "...fushat e Tiranës, që ndodhen midis kështjellës

GËZUAR KOSOVË, DITËN E PAVARËSISË!

Liria vjen pasi kombet fitojnë mbi pushtuesit dhe diktaturat.

Shqipëtarët pak më parë e Kosovarët pak më vonë, ja arritëm të jemi të lirë. Por lufta për demokraci dhe bashkim kombëtar është edhe më e gjatë. Arti dhe kultura janë krushqit e parë në dasmën bashkimit të kombit Shqiptar. Kam pasur fatin që si pjesë

e Shoqatave kulturorë, klubeve letërore apo grupeve muzikore të jem në Pejë dhe në Istog, në Skënderaj dhe në Klinë, në Gjakovë dhe në Rahovec, në Mitrovicë e në Podujevë, në Prishtinë e në Boletin, në Prizrenë e në Deçan, në Tuzin, në Guci dhe në Rozhaj.

Kujtime pafund dhe bindje e plotë, se bashkë i kemi rrënjët, bashkë kemi

gjuhën, bashkë kemi historinë, kemi kulturën dhe kemi traditat.

Kur' botën e sundonte feja, shqiptarët u bënë kurban herë tek turqit e herë tek sllavët... U desh të derdhej shumë gjak, u desh një Gjergj Kastriot dhe një Nënë Terezë, që Evropa dhe Amerika të binden se - NE JEMI i AUTOKTONË. se ne jemi vlerë e kulturës dhe e traditës

Evropiane. Pak rreshta dhe një set me foto për të uruar Festën e Pavarësisë ty Kosovë! Për të uruar miqtë e mi të politikës, artit dhe kulturës GËZUAR! GËZUAR!

Nga **Lulash BRIGJA**



së Petrelës dhe qytetit të Krujës". (... le pianure della Tirana, che sono fra il castello di Passarella e la citta di Croia) sipas I. Zamputit "Dokumente të shekujve XV – XVI, për historinë e Shqipërisë", vëll. I, Tiranë, 1989.

Në vitin 1431 – 32 bëhen disa regjistrime prone nga venecianet dhe rezultojnë, se Tirana kishte 60 qendra të banuara, me 1000 shtëpi dhe 7 300 banorë. Po ashtu, në regjistrin e kadastrës turke të vitit 1583, treva e Tiranës rezultojnë me 110 qendra banimi, me 2 900 shtëpi dhe 20 000 banorë.

Të gjitha këto statistika dhe të tjera që ekzistojnë, por mungojnë në këtë shkrim, u takojnë viteve para 1614, që na jepen si themelimi i qytetit të Tiranës.

Duke u kthyer te Sulejman Pashë Bargjini rezultojnë, se ai në shekullin e XVI kishte shkuar jeniçer në ushtrinë turke, arriti gradë madhore deri te grada Pasha dhe më vonë kthehet në vendlindjen e tij, Mulleti (o fshatin Bargjin afër Tiranës, që tani nuk është më). Në këtë vit, më 1614, u jep parat një grupi tregtarësh tiranas për të ndërtuar, po në Tiranë një xhami, një furrë dhe një hamam.

Sami Frashri në Enciklopedinë osmane (jo shqiptare) të Shkencës së Përgjithshme, shkruhet, se objektet e ndërtuara prej tij (S. P. Bargjini, Shën i aut) "si një trashëgimi përkujtimore e historisë së Tiranës" (Saimir Lolja artikull "Tirana e lashtë dhe përvjetorët e tij si kryeqytet", 02 / 2014)

Këto statistika flasin për një popullim të mjaftueshëm edhe për një qytet para se të vinte Pasha Bargjini dhe ndërtimi i këtyre objekteve nga ana e tij nuk u bën për shkak për popullimin e saj, se Tirana ishte populluar.

Ky nuk dëshmon asgjë për themelimin

e Tiranës si qytet. Përkundrazi. Fakti, se ai paratë për ndërtime ua dha tregtarëve, flet më se miri për ekzistencën e mirëfilltë të qytetit, të cilit tani iu shtuan tre objekte që nuk i kishte më parë. Pas mbarimit të këtyre objekteve mund të flitet për një qytet me dizinjë osmane me xhami e hamame. Në anën tjetër nuk ka asnjë të dhënë dokumentare, që tregon për ndonjë inaugurim o miting, se u themelua qyteti i Tiranës e të tjera.

Sulejman Pashë Bargjini, me një mbiemër kristian, tregon që i përkiste dikur ashtu si gjithë rajoni besimit të krishterë, por që e kishte braktisë përballë reprezaljeve turke kundër shqiptarëve si vrasjeve, konvertimeve dhe kryesisht depërtimeve me forcë. Populli ishte i pafuqishëm të kundërshtonte pushtuesin dhe në fund u detyrua ti nënshtrohet fatit. Viti 1595, sipas dokumenteve, flet për një shifër shumë të lartë, e cila shkon deri në 200 000 fëmijë, të cilët u morën për tu rekrutuar në trupat jeniçerë në luftën e Persisë. Kësaj masakre, siç duket, nuk i ka shpëtuar as djali i ri me emër të konvertuar në Sulejman.

Pashaj Sulejman është një tjetër shembull i mijëra shqiptaro – arbërorë, që mbas vdekjes së heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti, bënë grada në oborrin e Sulltanit, o nëpër gardat ushtarake turke duke i shërbyer shtetit osman si trupë dhe si fe. Një pjesë e tyre duke harruar prejardhjen shqiptare e duke mohuar fe e atdhe u rreshtuan në krahun e pushtuesit të vendit tyre e bënë shumë ekspedita në krye të forcave osmane për të nënshtuar popullin e tyre shqiptarë, masakruar e pushtuar atë.

Ndryshe nga figurat e tjera me prejardhje ilire të perandorisë romake si imperatorët të shtetit romak, të cilët bënë

ndërtime, përkrahën dhe ndihmuan njëri – tjetrin në karrierat imperoriale duke i dhënë fytyrën evropiane viseve ilire, këtë gjë nuk mund ta themi për karrieristët anadollakë me origjinë shqiptare, të cilët kombit të tyre i sollën vetëm të zeza.

Jeniçeri Sulejman, me gradën e pashës nuk u kujtua të hapte një shkollë, të ndërtonte një rrugë, por solli xhaminë, kultin dhe edukatën fetare turke në zemër të Shqipërisë, për ta tjetërsuar identitetin e saj. Dhe 400 vjet më vonë, këtij pashaj, për këtë "shërbim", shteti ynë sot i bën përmendore, i thurë lëvdata, i atribuon themelimin e Tiranës e aq më tepër zhbëjnë historinë, duke i ndërruar emrin Tiranës Ilire me Teheranin aziatik.

Në vijim të disa të dhënëve po mundohemi të tregojmë në stil telegrafik ritet e ngadalshme të ecjes së qytetit tashmë, gjysmë anadollak në kohën e më pastajme:

Dy shekuj më vonë, Tiranën e sundojnë Toptanët të ardhur nga Kruja.

Më 1780 ndërtohet kisha e Shën Prokopit dhe 9 vjet më vonë nis punimet xhamia në qendër e financuar nga Et'hem Beu e përfundon me 1821.

Kulla e sahatit ndërtohet me 1830 dhe është e lartë 35 m.

Ndër lagjet më të vjetra të Tiranës janë lagja e Pazarit dhe Bami. Vite më parë, kjo lagje është quajtur "Varri i Bami", që është varri i Ibrahim Kokonozit, por në të folmen tiranase është quajtur Bim e pastaj Bam.

Sipas statistikave Tirana si qytet, me 1703 kishte 4 000 frymë, me 1909 kishte 15 000 frymë, me 1938 kishte 38 000, me 1945 kishte 60 000 frymë.

Theksojmë, se popullimi i Tiranës është bërë sipas periudhave të sundimeve jo tiranas të këtij qyteti e krejt vendit. Toptani

solli në Tiranë krutanë e zonën përreth. Mbreti Zog solli dibranët e matjanët. Enver Hoxha e komunizmi sollën gjithë jugun dhe së fundi ndërrimi i sistemeve solli malësoret e të gjitha krahinave, ku sistemi i mëparshëm nuk lejonte lëvizjen e lirë të popullsisë. Sot Tirana gëzon 830 000 banorë.

Tirana shpallet kryeqytet i Shqipërisë më 8 shkurt 1920, sipas vendimeve të Kongresit të Lushnjës dhe merr statusin përfundimtar, me 31 dhjetor 1925.

Deri në kohën e pushtimit italian dhe koncesioneve të dhëna këtij shteti, Tirana kishte ritmin e zhvillimit shumë të ngadalshëm. Ndërtimet moderne italiane që shihen sot e kësaj dite u takojnë marrëveshjeve me Italinë dhe kjo e fundit jo se do të bënte një qytet modern shqiptar, por i interesonte për idenë e një bashkimi të mundësohem e aneksimit të saj më vonë.

Më 17 nëntor të vitit 1944 forcat partizane hynë në Tiranë duke zhvilluar dy ditë beteja me gjermanët në ikje e sipër, ku morën pjesë brigada e parë (Br1S) e katërta (Br4S) dhe e gjashta sulmuese (Br6S).

Në fund shtojmë se historianëve tanë dhe të shkencës sonë shqiptare i bie detyrë urgjente të iniciojnë përmes ndërhyrjeve në institucionet përkatëse që te behën korrigjimet e nevojshme për sa i përket shpjegimit të drejtë të prejardhjes së emrit të Tiranës, për heqjen përfundimtare nga "Enciklopedia Evropiane" e çfarëdo lidhje me Teheranin dhe vënien e identitetit të iliro - shqiptareve dhe qytetit mijërvjeçarë të Tiranës, në vendin që i takon sipas të vërtetës historike.

Nga Ndoc SELIMI

MË SHUMË SOLIDARITET ME TË SËMURËT DHE SA MË AFËR NJËREZVE NE NEVOJE

Në ditën botërore të të sëmurëve dhe punonjësve të shëndetsisë, pas kremtimit të meshës së shenjtë, në sallën Kardinal "Mikel Koliqi" u zhvillua një aktivitet fetaro kulturor i organizuar nga Karitas Dioqezan Shkoder, me mbështetjen e Komisionit "Drejtësi dhe Paqe". Të pranishëm përveç drejtuesve të kishës katolike, pra, të figurave të rëndësishme fetare, ishin edhe drejtues të shëndetsisë, drejtues të shoqatave pjesëmarrëse, punonjës të shëndetsisë si dhe punonjës të tjerë të këtij sektori nga Shoqata Projekti Shpresa, Instituti i Motrave të Nënë Terezës, Madonnina del Grappa e të tjerë. Aktiviteti u drejtua nga figura të dashura të qytetit të Shkodrës si Zef Ndoja dhe Ketlin Pjalmi. Pas përshëndetjes hyrëse të moderatorëve në fjalë, në skenë u ftuan të rinjtë e Shoqatës "Projekti Shpresa" të cilët u paraqitën me një poezi të titulluar "Rëndësia e buzëqeshjes" të recituar nga Romario Meta dhe Ardit Mancaku; me një kolazh këngësh shkoderane të kënduar nga Olgert Isanllari. Në vijim kanë performuar me pantonimën "Lulja e artë dhe shëndeti" me tekst të Suela Ndoja nëpërmjet të cilës u përçua mesazhi se ne duhet të tregojmë kujdes për shëndetin tonë e jo të neglizhojmë këshillat që na jepen. Këto performanca u përforcuan më pas nga fjala e Mons. Angelo Massafra i cili përcolli mesazhin: "Më shumë solidaritet me të sëmurët dhe sa më afër njerëzve në nevojë". Pasazhi përmbledhës i Mons. Massafra: "Të vazhdojmë të jemi afër atyre që kanë nevojë, të gjithë jemi nevojtarë, të gjithë kemi nevojë për një përkëdhelje, për një fjalë të mirë, kemi nevojë për një buzëqeshje, për dashuri... Prandaj të jemi të gatshëm të jemi dora e Zotit për ata që kanë nevojë, zemra e Zotit dhe goja sepse kemi nevojë..... thjesht sepse kemi nevojë për njëri tjetrin,.... në këtë ditë të kujtojmë të sëmurët jo vetëm ata që janë të pranishëm por edhe ata që janë nëpër shtëpitë e tyre nën kujdesin e kujdestareve dhe prindërve. "Ndërsa Mons. Massafra e mbylli fjalën e tij përshëndetëse duke theksuar: "Duke qënë të gjithë së bashku gjërat ecin së bashku dhe solidariteti ndaj problemit të të sëmurëve është më afër dhe kështu mund të ndjehemi si një familje e vetme sese jemi bijtë e Zotit". Ndërsa në vijim, Drejtori i Qendrës së Shëndetit Publik, Z. Astrit Beci kur mori fjalën e tij e nisi me një falenderim për Mons. Massafra, Motër Enca, dhe të gjithë kontribuesit, shoqatat, mjekët, të gjithë shoqatat, punonjësit e shëndetsisë dhe theksoi se të gjithëve së bashku na takon të bëjmë atë që ka thënë Nënë Tereza "me gjëra të vogla mund të japim dashuri të madhe". Aktiviteti vijoi me performanca të tjera të përgatitura nga vajzat e Institutit të Motrave të Nënë Terezës në kujdesin e veçantë të Adriana Marku. Gjithashtu në skenën e përvitshme, nuk munguan fëmijët e Shkollës Speciale "3 Dhjetori" nën kujdesin e mësueses së muzikës Zj. Violeta Paçrami dhe drejtueses së mrekullueshme Zj. Enkelelda Mataj. Po

kështu, skena u mbush edhe nga zërat e mrekullueshëm të të rinjve të Qendrës së Zhvillimit nën drejtimin e Zj. Rita Gjeçaj. Aktiviteti u animua edhe më shumë nga prania e këngëtarëve dhe figurave të tjera të dashura që kontribuojnë gjithmonë. Në fund të këtij artikulli, e mbyllim duke theksuar edhe pasazhe

jetën e saj, ishte shpërndarëse zemërgjerë e mëshirës hyjnore, duke u bërë për të gjithë e pranueshme nëpërmjet pranimit dhe mbrojtjes së jetës njerëzore, jetës së palindur dhe të braktisur e të hedhur. [...] Ajo është përkulur te njerëzit e rraskapitur, të lënë të vdesin buzë rrugëve, duke e parë tek ta dinjitetin që vetë Zoti

Tereza, figura që na ndihmon të kuptojmë që i vetmi kriter i aksionit duhet të jetë dashuria e dhuruar falas ndaj të gjithëve pa dallim gjuhe, kulture, kombësie e religjioni. Shembulli i saj vazhdon të na prijë në hapjen e horizonteve të gëzimit e të shpresës për një humanitet me dhembshuri e përkëdhelje, posaçërisht



nga mesazhi ndërkombëtar që ka dhënë Papa Françesku me rastin e kësaj dite të rëndësishme i cili referohet figurës më të dashur të njerëzimit në nevojë dhe të të sëmurëve. "Nënë Tereza, në gjithë

ua kishte dhuruar; ka bërë që zëri i tyre të dëgjohet prej të pushtetshmëve të kësaj bote, që ta pranojnë fajin e tyre për krimet [...] e varfërisë që ata vetë e kanë krijuar. Prandaj, le të jetë Shën Nënë

për ata që vuajnë."

Përgatitur nga:
Suela Ndoja e Adriana Marku

KËNGËTARI QË SFIDON MOSHËN

Për të gjashtin vit radhazi në Shkodër, Agjensia e Spektakleve “Buna 1”, me president dhe producent z. Arben Mazi, organizon spektaklin “BEST 10 NORTH”, ku këngëtari Bashkim Alibali nderohet me “Çmimin e karrierës”

Një shkrim i këtyre përmasave është si të thuash një kornizë e vogël për ta përballuar hapsirën e portretit të këtij këngëtar kaq të veçantë, karrierën 50 vjeçare të këtij “rrebeli” të dashuruar me këngën dhe skenën, i cili gjithmonë me talentin e tij vetëm “korniza” nuk ka pranuar.

Bashkim Alibali është një këngëtar shumë i njohur në Shqipëri. Lindur në Tiranë dhe rritur në Shkodër. Ishte mjaft i ri kur erdhi në Shkodër dhe ruan shumë kujtime në rininë e tij me lidhjet miqësore, që kur ka filluar të këndoje me shokun e tij të rinisë Tonin Tërshana, si hobi rinie. Këndonin serenata në rrugët dhe rrugicat e Shkodrës, nën qiellin e pastër pranveror dhe nën dritën e vakët të llampave elektrike që ndriçonin në shtyllat prej druri.

Këtë shkrim po e filloj me një rrëfim të singertë e nostalgjik të Bashkimit: “BEST 10 NORTH 2018”. “Për herë të parë kam kënduar në shtëpinë e kulturës së qytetit të Shkodrës, ku e pëlqyen zërin tim dhe më aprovuan të marr pjesë në festivalin e këngës së qytetit të Shkodrës. Zërin tim e zbuloj z. Nard Bushati, i cili ishte drejtor i klubit të rinisë “Heronjtë e Vigut”. Ai më hapi rrugën e skenës me thjeshtësi e me dashuri dhe më vjen keq që njerëz të tillë shpesh rrinë në heshje”.

Jeta artistike e qytetit të Shkodrës ishte mjaft e pasur dhe e larmishme. Vetëm teatri “Migjeni” funksiononte si trupë profesioniste, por burimi që vazhdimisht e furnizonte me talente të rinj ishin trupat amatore të ndërmarrjeve dhe institucioneve të qytetit. Në këto ujëra të pastra të këtij burimi u zbuluan shumë talente të ardhshëm, ku spikat edhe këngëtari simpatik, alegro e gjithmonë rinor Bashkim Alibali që punonte në uzinën e telave në Shkodër.

Shkëlqimin në jetën artistike, asnjë artist nuk mund ta bëjë i vetëm, pa bashkëpunimin e një stafi ku anëtarët plotësojnë njëri tjetrin. Në këtë kontekst Bashkimi pati fatin e madh të ketë përkrah personalitetet më të spikatur të muzikës dhe artit shkodranë si: i paharruari Bik Ndoja “Nderi i Kombit”, Shyqyri Alushi - “Artist i Merituar”, por edhe të planit të estradës si: Tano Banushi, Zyliha Miloti, Paulin Preka, Jolanda Shala, Gëzim Kruja, Zef Deda, e të tjerë.

Në moshën 17-vjeçare mori pjesë në festivalin e këngës të qytetit të Shkodrës, ku ishte dalja e parë në skenë me një publik të gjerë. Lëvizja artistike kulturore

e atëherëshme në qytetin e Shkodrës ka qenë shumë e gjallë. Ka pasur shumë veprimtari, sidomos amatore. Jo vetëm Shtëpia e Kulturës, por ka pasur shumë ndërmarrje që organizonin estrada, festivale apo aktivitete të tjera.

Ishte viti 1969 kur Alibali filloi të aktivizohet me trupën e estradës profesioniste të qytetit të Shkodrës. Pjesëmarrja në këtë trupë përkon me shkuarjen në Tiranë me një veprimtari dhe kënga e parë që ka kënduar në sallën e Estradës së kryeqytetit ka qenë “Mes jush”.

Jeta e Bashkim Alibalit është lidhur mes Tiranës dhe Shkodrës. Ai ka një jetë interesante, mbushur me ngjarje, ku pasioni dhe këmbëngulja i kanë dhënë një vend të nderuar në radhët e këngëtarëve më të shquar shqiptarë. I qeshur dhe plot humor, ai ka ditur të ngrihet mbi çdo barrierë të kohës, ku magjia e zërit të tij ka qenë vetë çelësi i sukseseve të tij.



Si shumë këngëtarë bashkëkohës, Festivali i 11-të e mënjanoi nga skena, por jo nga dëshira për këngën. Në biseda, shokët shpesh e ngacmojnë për sqimën dhe rigorozitetin e tij në veshje dhe pamje. Është ndoshta i vetmi këngëtar shqiptar që nuk ka dalë asnjëherë nga shtëpia pa e kontrolluar edhe një herë veten për paraqitjen e tij. Miqtë e tij janë kompozitorët, këngëtarët, autorët e teksteve, me të cilët diskuton gjerësisht për këngën, rolin dhe pozicionin që ajo duhet të ketë në kulturën dhe shoqërinë e sotme shqiptare.

E pranojmë, se jeta ka ndryshuar dhe është në zhvillim, por duhet të pranojmë se edhe kënga popullore shkodrane e vjetër duhet të ruhet dhe zhvillohet, pasi në të është shkrirë talenti, fantazia

e shpirti i brezave të tërë krijuesish me emër dhe anonim, ndryshe nuk mund t'i themi më “Këngë shkodrane”. Një ndër ata është edhe Bashkim Alibali, i cili herë pas here edhe në ditët tona na sjell perla të mrekullueshme që ndriçojnë me shkëlqimin e kësaj muzike të papërsëritshme. Megjithatë shkëlqimi i tij më i madh ka qenë në interpretimin e këngës së muzikës së lehtë.

Në një bisedë me këngëtarin Bashkim Alibali, i qeshur e i qetë, jetën e përkufizon si një udhëtim, ku njeriu duhet të punojë për të gjetur vetveten, duke respektuar vlerat dhe shmangur të kundërtat, zbuluam disa detaje interesante për festivalet në RTSH, kur është ngjitur për herë të parë në skenë në festivalin e dhjetë me këngën “Stacioni i dashur”.

Bashkim Alibali rrëfen: “Para provave të përgjithshme ma hoqën këngën për interpretim ekstravagant, mbasi unë bëja disa lëvizje që nuk i lejonte ajo kohë.

dilte. Kur filloi muzika, magjia e saj sikur më zgjoi. Ajo ishte lajmërimi që duhej të kontrolloja veten. Në fytyrë më erdhi një buzëqeshje e brendshme. E mblodha veten. Muzika hyrëse po më rregullonte gjithë atmosferën e brendshme. Kur erdhi momenti të filloja, emocionet i kisha flakur. Zëri erdhi i plotë, i qartë, i pastër, ashtu si e doja unë”.

Më pas Alibali tregon për festivalin e 11-të në RTSH: “Mora pjesë me një këngë interesante për studentët. “Mbrëmja e fundit” titullohej kënga. Pra, kur studentët mblidhen në natën e fundit, duke kujtuar shumë ditët e shkollës, sepse të nesërmen do të shpërndaheshin. Teksti dhe muzika e Enver Shëngjergjit, nën orkestrimin e Aleksandër Lalos. Ishte një këngë e suksesshme, ku natën e parë të pranishmit më kthyen dy-tre herë. Ishte koha që studentët kishin ndikim në jetën kryeqytetase, por, çuditërisht kjo këngë nuk fitoi asnjë çmim! Megjithatë, dola i kënaqur nga festivali. Kënga ishte e bukur dhe u pëlqye, por të këqijat erdhën mbrapa. Ky festival u kritikua shumë. Këngëtarët më të mirë u kritikuan për tendencë borgjezo-revizioniste, për shfaqje të huaja, e të tjera.

Edhe më vonë më kritikuan për ekstravagancë dhe kush? Njerëz që nuk e kishin parë fare festivalin. Pra, deri në vitin 1978, këndoja vetëm në estradën e ndërmarrjes këngë popullore, këngën e lehtë nuk e lëvrova. Më dukej vetja bosh, përfundon Alibali në rrëfimin e tij”.

Bashkim Alibali rikthehet përsëri në skenë në Festivalin e 17-të dhe përsëri mori pjesë me një këngë të Enver Shëngjergjit. Pas këtij Festivali ka marrë pjesë me ndonjë shkëputje në të gjitha festivalet në RTSH. Në festivalin e 20-të, Alibali mori çmim të parë me këngën “Çel si gonxhe dashuria”, me muzikë të Kotanit dhe tekst të Arben Dukës. Në eksperiencat e Alibalit përveç Festivaleve në RTSH, mund të veçojmë:

“Kur vjen Pranvera” në vitin 1985, ku u vlersua me çmim të parë, i cili ishte si rezultat i të madhit Ferdinand Deda. “Në duart e nënës”, kompozim i Gjergj Lekës. Ishte ndërhyrja e Ferdinand Dedës, që kjo këngë të futej në konkurrim. Për artistin nuk kishte rëndësi rregulli, por arti.

Kënga “Në duart e nënës” veçohet nga të gjithë, ajo është bërë si këngë shtëpie, kjo këngë u bë popullore dhe tregoi se edhe një këngë e muzikës së lehtë mund të bëhet këngë masive. Bashkimi nëpër festivale dhe koncerte ka marrë edhe katër çmime të dyta dhe tre çmime të treta. Bashkëpunimet kryesore me kompozitorë dhe autorë tekstesh i ka pasur me Zhuljana Jorganxhi, Arben Duka, Betim Muço, ku nuk mund të lihet pa përmendur bashkëpunimi që vazhdon

Jo se i bëja me qëllim, por instiktivisht, pasi e ndjeja këngën. Mora rrugën për në Shkodër, por ishte Alfons Balliçi ai që bëri përpjekje të tjera që të rikthehesha dhe të ngjitesha në skenë. Atëherë më dhanë një këngë tjetër “Qyteti punëtor”. U ngazëlleva. Ishte një moment i veçantë. E kalova me sukses. Nuk ishte e lehtë të merrje pjesë në një festival të tillë në atë kohë. Kishte shumë kërkesa nga ana profesionale”.

Pjesa e dytë, “kishte të bënte me ngjitjen në skenë. Moment magjik! Po realizohej ëndrra ime më e madhe, ëndrra që këngëtarët e asaj kohe e kishin në çdo hap të jetës. Kur hyra në skenë më dukej se të pranishmit më shihnin me mosbesim. Këmbët filluan të më dridheshin. Më dukej se zëri nuk do të më

edhe sot e kësaj dite me mikun më të madh të të gjithë këngëtarëve, poetin e pashtershëm Jorgo Papingji. Sukseset e tij ia dedikon edhe kompozitorëve Gjergj Leka, Jetmir Barbullushi, Flamur Shehu, Vladimir Kotani, Edmond Zhulali, Sokol Marsi e të tjera.

Nga viti 1988, deri në vitin 1990, Bashkim Alibali ishte Drejtor i Pallatit të Kulturës “Vasil Shanto” në Shkodër. Një institucion, të cilin përpara tij e kishte drejtuar shkrimtari dhe poeti i njohur shkodran Bedri Islami. Edhe Bashkimi ashtu si paraardhësit e tij i vuri një rëndësi të madhe këtij institucioni, i cili merrej kryesisht me trupat amatore të ndërmarrjeve të qytetit dhe me talentet e reja.

Kështu veprimtarite vazhduan njëri pas tjetrit duke organizuar edhe disa turne me trupën amatore të këtij Pallati në mbarë vendin. Vetëm në Tiranë, kjo trupë ka dhën mbi 70 shfaqje dhe mbi 30 shfaqje në qytetet e tjera.

Gjatë kohës, që Bashkimi ka qenë drejtor i këtij institucioni, u plotësua me të gjitha instrumentët muzikore, me foni e ndriçim, me një skenë të madhe, e cila në atë kohë plotësonte të gjitha kushtet e nevojshme, duke u bërë edhe skena e trupave amatore të ndërmarrjeve, institucioneve dhe trupave që vinin nga fshati dhe rrethet. Niveli i organizimit të këtyre aktiviteteve jo vetëm gjallëronte jetën e qytetit, por shpesh konkuronte edhe trupën profesioniste të Teatrit “Migjeni”, sepse vetë institucionin e drejtonte njeriu i duhur, artisti i duhur.

Alibali e ka shumë për zemër muzikën e lehtë, por duke parë se në ambiente familjare këndohet më shumë kënga popullore, kjo tregon se ai është i dhënë edhe pas kësaj kënge. Për këtë ka ndjekur shembullin e këngëtarit të shquar të këngës popullore shkodrane Bik Ndoja, sot “Nderi i Kombit”. Edhe tek kjo gjini kënge, Bashkim Alibali i është përmbytur këngës tipike shkodrane, por edhe të krahinave të tjera.

Në repertorin e e tij me këngë popullore shkodrane numërohen rreth 250, që ka kënduar Bashkim Alibali, ndërsa këngë popullore Shkodra ka me qindra.

I gjendur kudo ku ka veprimtari, Bashkimi mbetet këngëtar i më i palodhur. Dhe pse lëviz kudo, dashuria për Shkodrën nuk i shterron kurrë dhe kur shkon aty duket se frymëzimi i shtohet.

Bashkim Alibali jo vetëm në Shqipëri, por dhe në disa vende të botës ka dhënë koncerte: Në Angli, Greqi, Kanada, Austri, Gjermani, Itali, në shumicën e vendeve ku ka emigrantë shqiptarë. Vendi që i ka lënë më shumë përshtypje për nga pritja dhe brohoritjet ka qenë Greqia. Në këto koncerte këngët janë kënduar së bashku me Alibalin dhe shpeshherë të gjithë janë ngritur në këmbë. Në ambiente të tilla gjithmonë ka ndjerë diçka të veçantë. Në këto koncerte ka kënduar këngë popullore dhe këngë të muzikës së lehtë, duke pasur një repertor të zgjedhur si kënga “Në duart e nënës”, “S’ma njohe zemrën”, “Lule delet”, “E imja Shota”, të cilat kanë qenë më të kërkuarat.

Këngëtarët më të preferuar për Alibalin janë: Vaçe Zela, Bik Ndoja, Ibrahim Tukiçi, Fitnete Rexha, Naile Hoxha dhe shumë të tjerë. Për muzikën e lehtë Tonin

Tërshana, shoku i tij i fëminisë, ndërsa shpërblimi më i madh që ka marrë si këngëtar janë duartrokjet e shumta në koncerte dhe përshëndetjet e njerëzve në rrugë. Këto janë më shumë se çmimet.

dhjetë këngët e kënduara në fillim ishin këngë të traditës të mirëfillta burimore, kurse dhjetë këngët që u kënduan më pas ishin të kompozura enkas për këtë festival, kur u ngjit në skenë mjesbthri



Edhe pse nuk ka mbaruar për kompozitor, Bashkim Alibali si një nga këngëtarët emblematic në festivalet e RTSH-së prezantohet për të konkuruar në edicionin e 50-të, në vitin 2012 si kompozitor dhe interpretues me këngën “Merr me vete këngën time”, me tekst të Jorgo Papingjit - “Mjeshtëri i Madh”, e cila bën fjalë për këngën tonë shqiptare, duke u ngjitur në skenë pas 7 vitesh, pas duetit të suksesshëm me këngëtaresh Irma Libohova, i titulluar “Taverna e vjetër”.

Në festivalin e dytë të këngës popullore qytetare që RTSH organizoi në teatrin e Operës dhe Baletit në Tiranë, ku morën pjesë dhjetë këngëtarë popullor të përzgjedhur nga trevat mbarëshqiptare, të cilët kënduan nga dy këngë secili, ku

shkodran, Bashkim Alibali, me këngën e vjetër shkodrane “Hajde moj manush”, solli entuziazmin e pashoq shkodran. Spektatorët në sallë duartrokisnin pa pushuar, duke kënduar edhe ata bashkë me këngëtarin. Kënga e dytë, që u interpretua nga Bashkim Alibali, ishte një këngë e re titulluar, “Shkodra jeme, zemra jeme”, me tekst të poetit të shquar Jorgo Papingji dhe muzikë të kompozitorit Davit Tukiçi, e cila ishte një ndër këngët më të suksesshme të këtij festivali që u prit me shumë ngrohtësi.

Tashmë, vlersimin më të madh që ka ky artist, është në këngën e tij, të vjetër e të re, këngë e cila nuk shteron kurrë, por vetëm skalitet e gdhendet më bukur se asnjëherë, duke depërtuar tek

çdo shqiptar, nga veriu në jug e në çdo cep të botës ku flitet shqip. Karriera e tij artistike tha shumë, që si rrallë kush ka ditur të elektrizojë salla e mjedise të ndryshme, që ka ditur mjeshtërisht ta kthejë dhimbjen në gaz, që i dha kohës së shkuar koherencën e ditëve të ardhshme, por një jetë me këngën e tij është një histori që dekoratat e sotme nuk mund ta thonë.

Bashkimi është dhe mbetet këngëtar i të gjitha kohërave, duke qenë gjithmonë i dashur, elegant, simpatik, si dhe duke na dhuruar gjithmonë emocione me këngët e bukura me zërin e tij joshës.

Kohët e fundit, publiku shkodran ndoqi me vëmendje koncertin që dha teatri “Migjeni”, për të cilin duhen falenderuar përzemërisht organizatorët dhe veçanërisht udhëheqsi artistik i këtij koncerti, mjeshtri Ilir Zoga, realizuesin drejtorin e këtij teatri z. Edmond Angoni, si dhe Bashkinë Shkodër, që bënë të mundur edhe pjesëmarrjen e këtij artisti shkodran në vendlindjen e tij. Publiku sa u gëzua njëherësh edhe u permallua.

Në Festivalin “Kënga ime” organizuar këtë vit nga TV Klan, Bashkim Alibali u vlerësua me çmimin e karrierës.

Mendoj, se veç një shkrim, është shumë pak për të promovuar dhe treguar gjithë punën dhe krijimtarin 40 vjeçare të këtij artisti, që solli shumë e shumë këngë të bukura, duke u vlersuar edhe me çmime të ndryshme, të cilat do të mbeten dhe do ta mbajnë të gjallë këngën e bukur shqipe.

Këngët e Bashkim Alibalit nuk mbeten vetëm për Shkodrën, por mbeten për të gjithë shqiptarizmin. Ai është krenari e artit dhe muzikës shqiptare. Mirënjohje vlerave të tij për promovimin e imazhit më të mirë të traditës historike, kulturore e patriotike të Shkodrës tonë e mbarë kombit shqiptar, djepit që e rriti dhe Shkodrës që e frymëzoi. Vlerat e këtij këngëtarit të njohur na bëjnë krenar për trashëgiminë e shkëlqyer që e ka pasuruar me zërin e tij të dashur dhe këngët e bukura të arkivës më të mirë të artit shqiptar.

Bashkim Alibali edhe sot e kësaj dite është aktiv dhe si i tillë nuk përton të marrë pjesë edhe në krijimtari të reja, të cilat ai më shumë se askund i kërkon, i realizon dhe i interpreton në qytetin e tij të dashur në Shkodër. Në këtë kontekst mund të përmendim edhe dy këngë të mrekullueshme titulluar: “Andërr e vjetër” dhe “Don Zhuan”.

Të gjitha këto vlera u pasqyruan në naten finale të “BEST 10 NORTH 2018”, në skenën e Teatrit “Migjeni”, ku dashamirësit e artit shkodran, dashamirësit e sportit shkodran, dashamirësit e përparimit të këtij qyteti kaq të mrekullueshëm, votuan më të mirët e këtyre fushave dhe unë në shkrimin tim veçova këtë këngëtar të mrekullueshëm që mund të plakët, por me zërin e tij do të mbetet përherë ri.

Nga Ramazan ÇEKA, Janar 2019

EFEKTI I LUCIFERIT NË MIRËQËNIEN E PËRGJITHSHME SHQIPTARE

Le të shikojmë për pak momente figurën e paraqitur. Tani ju ftoj të mbyllni sytë dhe ta rregjistroni në kujtesën tuaj. A sheh mendja juaj ndonjë pjesë të errët apo ndonjë pjesë që lëshon dritë. Ndoshta disa prej jush mund ti përfytyroni të dyja pjesët. Por sapo të mund të vetëdijësoheni se ekzistojnë në mendjen tuaj të dyja pjesët, ju nuk mund të shihni më vetëm njërin por të dyja. Tri të vërteta psikologjike dalin nga imazhi i Escher. Së pari, bota është e mbushur me anën e mirë dhe anën e keqe. është, do të jetë gjithmonë. Së dyti, pengesa ndërmjet anës së mirë dhe anës të keqe është e përshtueshme dhe e mjegullt. Dhe së treti, është e mundur që engjëjt të bëhen djajtë dhe, ndoshta më të vështirë të konceptojmë, që djajtë të bëhen engjëj.

Çfarë do të thotë kjo? Në shoqërinë tonë shqiptare, jemi shpesh viktimë të atij kurthi mendor që na pengon të mendojmë se një person apo grup personash të mund të sillet/sillen në një mënyrë të caktuar në fusha të ndryshme të jetës siç janë: arsimit, drejtësia, ekonomia dhe shëndetsia. Kur ndodh, ne mbetemi të habitur, për ne nuk ishte diçka e parashikueshme edhe pse në vetvete mund ta kemi imagjinuar si në rastin e figurës por nuk e kemi lidhur me veprimin. Efekti i Luciferit është pikërisht ky, që përshkruan momentin kur një person apo popullatë “normal/e” kalon vijën ndërmjet të mirës dhe së keqes. Ai/ ajo përfaqëson një transformim të një karakteri njerëzor që është i rëndësishëm në pasojat e tij. Për shembull, një rini e tërë shqiptare ngrihet në këmbë për të drejtat e tyre me qëllim rritjen e cilësisë së arsimit. Një grup i tërë infermierësh ngrihet në këmbë për përmirësimin e kushteve shëndetsore nëpër spitalet ku u shërbejnë njerëzve të sëmurë. Grupe të caktuara politike vullnetarisht duan të braktisin përgjegjësitë e tyre sociale, profesionale dhe institucionale. Grupe mjekësh dhe infermierësh kërkojnë të largohen nga Shqipëria ngaqë nuk ofrohen mundësi punësimi, grupime të mëdha njerëzish kërkojnë ndihmë ekonomike për shkak të kushteve të mjerueshme në të cilën ata ndodhen. Grupe të mëdha fëmijësh në situatë rruge ose të braktisur. Grupe të caktuara njerëzish vuajnë nga shqetësime psikologjike për shkak të kërkesave të paërbalueshme jetësore, etj. Gjithçka varet nga kushtet ekzistuese, pasi ato janë ato që i bëjnë njerëzit e mirë dhe të këqinj sipas termit “Efekti i Luciferit” që është shpikur nga P. Zimbardo, krijues i eksperimentit të tmerrshëm të burgut të Stanford-it. Zimbardo (1971), u frymëzua nga studimet e G. LeBon mbi sjelljen shoqërore. Në thelb teoria për të cilën një individ i zhytur në një turmë tenton të humbasë identitetin e tij personal duke iu përshtatur vullnetit dhe moralit të grupit. Gjatë eksperimentit, ishte verifikuar dhe kishte ndodhur Efekti i Luciferit. Vlen për të theksuar që ditën e pestë, disa pjesëmarrës treguan

shenja të shqetësimeve emocionale dhe

nga përgjegjësia. I liron ata që të marrin parasysh vetëm rolin e tyre të mundshëm në krijimin, mbrojtjen, përjetësimin ose pranimin e kushteve që kontribuojnë në kriminalitet, shkelje ligjore, vandalizëm, ngacmim, bezdisje provokuese, përdhunim, torturë, terror dhe dhunë. Një njeri i mirë mund të bëhet “i keq” kur zgjedh “tiraninë e konformitetit”, ose bindjen e verbër ndaj urdhrave të pavullnetshëm duke menduar se është duke kryer rolin e vet e thuajse duke e identifikuar veten me një hero. Pas retorikës së Zimbardos, statusi heroik nënkupton atributet shoqërore, të cilat japin nder për një person/



simptomave të përçarjes individuale dhe kolektive, meqë pjesëmarrës të tjerë kishin nxjerrë një anë sadiste që nuk ishte shfaqur gjatë procesit të përzgjedhjes. Në këtë pikë eksperimenti u ndërpre papritur me shumë zhgënjim siç ndodhin fenomene të tilla në shoqërinë tonë shqiptare kur në një kauzë të drejtë përfshihen edhe forca të tjera të cilat e ndërlikojnë misionin fillestar. Në praktikë, personalitete të caktuara fshehin anët e panjohura që tentojnë ti manifestojnë sa më shpejt që tu jepet mundësia. Për këtë arsye Zimbardo, bazohet në faktin se ne të gjithë kemi një të mirë dhe një pjesë të keqe brenda nesh. Njëra qëndron më shumë se tjetra në bazë të situatës konkrete që jetojmë, e cila favorizon shfaqjen e një versioni të nesh ose të një tjetër. Për më tepër, për të mbështetur se ekziston një dikotomi **E keqe - E mirë**, i shtjellon “njerëzit e mirë”

person për veprimet e tij/tyre, por jo për efektet e tyre që mund të lënë më pas në kujtesën afat gjatë. Në një vështrim më të afërt, Zimbardo argumenton bindshëm se situata dhe institucionet janë të rëndësishme thjesht sepse njerëzit nuk janë objekte pasive. Ata zgjedhin sjelljen e përshtatshme sipas klimës në të cilën ata qëndrojnë, duke optimizuar përfitimet për të minimizuar kostot. Kjo është logjika që mbetet pas çdo reagimi shoqëror nga paqësor deri në masakra. Përveç kësaj, psikika jonë nuk përfshin as të mirën as të keqen. Të dyja sjelljet padyshim që dalin në sipërfaqe vetëm nëse një situatë çon në luajtje të një roli, që lëviz individët për të vepruar në mënyrë të veçantë, nga mosveprimi në veprim. Efekti i Luciferit është prodhuar si pasojë e situatave që favorizojnë fuqinë shoqërore dhe rrugën e së keqes së domosdoshme. Shumica

prej nesh do të dorëzohej në anën e errët nëse do të kishim kushtet e duhura, nëse do të ishim të zhveshur nga identiteti ynë dhe do të ishim kushtëzuar të ushtronim role të caktuara autoritare. Lidhur me këtë, është interesante të citosh atë që Papa Gjon Pali II tha për Qiellin dhe Ferrin. Sipas tij, “Qielli dhe Ferri janë brenda nesh, kështu që ne nuk mund t’i shmangim ato”. Nuk është e nevojshme që të jesh katolik për të kuptuar këtë pohim, ne thjesht mund ta përdorim atë për të analizuar realitetin e faktit se ne nuk jemi gjithmonë të mirë me të tjerët. Ne duhet të eliminojmë idenë se “ligësia” është diçka anormale dhe madje patologjike. Askush nuk është krejtësisht i mirë ose tërësisht i keq: ne jemi një shkallë gri në të cilën mbizotërojnë të bardha dhe nganjëherë të zeza dhe ndikon në mirëqënie e përgjithshme bazuar edhe në kontekstin në të cilin gjendemi dhe sistemi që e mbulon këtë kontekst. Në librin e tij “Efekti i Luciferit: Kur e mira bëhet e keqe”, Zimbardo u kërkon njerëzve të mbajnë “nën kontroll” jo vetëm vetveten, por edhe udhëheqjen e çdo organizate që është shumëkombëshe, politike dhe fetare. Kjo, meqë “Mendja ka një aftësi të pafundme për ta kthyer cilindo person në të dashur ose mizor, të dhembshur apo egoist, krijues apo shkatërrues dhe për të bërë dikë hero dhe dikë tjetër antihero”. Prandaj së fundmi, përpiquini të rikujtoni imazhin që keni ruajtur në kujtesën tuaj afatgjatë. A vazhdon mendja juaj të shohë ndonjë pjesë të errët apo ndonjë pjesë që lëshon vetëm dritë. Ndoshta disa prej jush mund të vazhdoni të përfytyroni të dyja pjesët... Ndoshta disa prej jush kanë akoma nevojë për të riparë imazhin...

Përgatitur nga: **Suela Ndoja**

I VOGËL SI NAPOLON, POR JETOVE E VDIQJE ME NDERË

Homazh per Mark Marash Podin

Pema e jetës së Mark Marash Podit u këput në rrethin e 70-të. Dhimbja për shkimatjen tënde që prezentë, e arsyeshme dhe e lexueshme në sy te të gjithë atyre që të njohën. Le pas

një familje të nderuar, shëmbëlltëre e fytyrës dhe personaliteti tuaj.

Ike para kohë i paplakur duke pikëlluar gjithë farefisni që kishte përse të mburrej me ju.

Breznia jote e Shoshit sot humbi një burrë trup vogël që la bosh një rojë të madhe.

Ju ishit një brezni më lartë se unë, dhe një kat më poshtë se gjyshi im, të cilin e respektove me dashamirësi. Ju kam dëgjuar disa herë duke bërë kuvend dhe romuze me njwri tjetrin.

Mark, gjyshi im i mençur ju vlerësonte dhe ju çmonte, jo për sevap, por se ju e meritoni respektin e tij

Me thjeshtësinë, origjinalitetin, bujarinë, tervesën dhe mirësjelljen tënde fitove respektin burrave me të syzuar të Shoshit si Marsh Babuni, Sokol Delia, Gjon Marshi, Nuk Vuksani, Çun Delia, Gjergj Marku, Nikë Gjeloši, Pjeter Koca, Kolë Micani, Ndue Biba, Prekë Gjeloši,



PËRSE BURRAT I DHUNOJNË GRATË?

Burrrat do të ishin shumë më burra nëse, nuk do të mundoheshin të tregonin, sa burra janë. Nuk janë aq sa tregohen. Janë shumë më të dobët nga sa duken dhe tregohen. Pika më e dobët e tyre është, mungesa e kontrollit mbi vetveten. E kanë shumë të vështirë që t'i vënë nën kontroll impulset e dhunës. Psikologët mendojnë se, 50 për qind e konflikteve midis burrave, të cilat përfundojnë në dhunë, deri në marrje jete, shkaktohen për gjëra vulgare, motive të dobëta. Rol shumë të madh luan mjedisi, familja, të afërmit dhe shoqëria, në sytë e të cilëve, burri duhet të tregohet burrë. Tek meshkujt, pas një ligësie, gjithmonë fshihet një dobësi, një pikë e dobët.

Shumë burra vuajnë nga ndjenja e inferioritetit, e mendojnë veten të dobët. Burrrat që vuajnë nga një ndjenjë e tillë, ndjehen keq para një gruaje konkrete si dhe para njerëzve të tjerë, aty ku nuk përfillen dhe humbasin krenarinë mashkullore. Ata nuk e durojnë dot një status të tillë dhe mundohen ta kompensojnë me një sjellje apo veprim agresiv. Një burrë i vetëdijshëm, kryelartë, nuk dhunon kurrë, nuk ka nevojë ta bëjë një gjë të tillë. Shumë meshkuj karakterizohen nga mungesa e madhe e fleksibilitetit, janë shumë të ndjeshëm. Nuk duhet menduar, se burrrat janë më të ndjeshëm se gratë por, kur është fjala për natyrën e tyre mashkullore, ata janë të padurueshëm. Nëse i thuhet një burri se “ti nuk je gjë si burrë”, është shumë më e rëndë për burrin se sa për gruan, nëse i thuhet asaj, “ti nuk je gjë si grua”.

Burri që nuk është i sigurtë në burrërinë e vet, është shumë i rrezikshëm për gruan. Në të gjitha rastet kur burri përdorë dhunë mbi gruan, e mendon veten poshtë saj, pozicion të cilin ai nuk e duron dot. Nuk e duron dot femrën “hundëpërpjetë”.

Dhuna seksuale, në shumë raste, nuk ka të bëjë me dëshirën për seks por, shumë

më tepër, për t'ia ulur hundën një gruaje ose për të poshtëruar burrin e saj. Kjo ka shpjegimin e vet nga ana psikologjike: “Mashkullorja, për psikozën e burrave, është gjëja më madhore. Burrrat studiohen si meshkuj kur ndahen përfundimisht nga gjinia femërore (në moshën e pubertetit)”.

Ndjenjat dhe sjelljet femërore, të cilat gjenden në natyrën e tyre, duhet t'i manipulojnë vetë pasi nuk i shkojnë natyrës mashkullore dhe i mendojnë rrezik për identitetin e tyre. Kjo fillon, që në moshën fëmijore ku djemtë tregohen “harbut” me nënat, solidarizohen me etërit (solidaritet mashkullor), përçmojnë gjininë tjetër (motrat), sillen si homofob. Djali mendon: “Unë dhe babi, jemi njerëzit më të rëndësishëm këtu!” E thënë shkurt: Mashkullorja bazohet në mospranimin e femërores. Me këtë princip, angazhohen të gjithë meshkujt dhe pjesa më e madhe ia dalin. Të tjerët vuajnë dhe i bëjnë edhe të tjerët, kryesisht femrat, të vuajnë.

Për burrin, tri gjëra janë jetike: “Pushteti, paraja, seksi!” Nga të tria këto, më e rëndësishmja është pushteti. Çdo mashkull, të paktën diku, ëndërron të jetë i plotpushtetshëm. Nëse nuk ia del jashtë familjes, ai e provon këtë në familje, me gruan dhe fëmijët. Nëse edhe aty dështojnë, vuajnë nga ndjenja e inferioritetit. Pavarësisht nga sjellja e gruas, meshkujt që vuajnë nga ndjenja e inferioritetit, nuk ndjehen kurrë të sigurtë. Kjo nuk është vetëm në jetën bashkëshortore. Burri mund të ndjehet i poshtëruar edhe në punë, nga shefi apo kolegët, në raste humbje apo të frikës së humbjes, të frikës së rënies në situata të vështira. Situata të tilla mund t'i shkaktojnë ndjenjën e hakmarrjes. Të gjithë meshkujt, pavarësisht nga moshja, funksioni dhe shkollimi, mund të përjetojnë situata të tilla. Nuk ka asgjë për tu çuditur nëse në ekranin e televizorit shikojmë një personalitet të njohur, tani si autor krimi, në familje apo diku tjetër. Ata verbohen para një iluzionit, e marrin atë për të vërtetë dhe ... gruaja e tij por, dhe dikush tjetër, e paguan me shëndetin apo dhe jetën. Meshkujt që nuk e ndjejnë veten burrë në nënlëkurën e tyre, përbëjnë

rrezik, për veten e tyre dhe të tjerët. Më të rrezikuara nga të gjithë janë gratë dhe vajzat e tyre. Gradualisht ata pësojnë çrregullime të mëdha të personalitetit. Ndër të tjera, sëmuren nga ndjenja e xhelozisë. Sëmuren aq rëndë sa, nëse nuk e gjejnë “dashnorin” e gruas, fiksojnë njërin dhe menjëherë, ia merr jetën atij ose gruas. Të vrasin për një shikim, për një buzëqeshje, për një përshëndetje. Burrrat që vuajnë nga ndjenja e hakmarrjes, edhe pas ndarjes me bashkëshorten, nuk e lënë kurrë të qetë atë. E ndjekur nga pas, trillojnë gjëra të paqena me qëllim që ta diskreditojnë në sytë e të tjerëve. Përpiqen ta rrenojnë përfundimisht.

Një burim tjetër i dhunës së burrit mbi gruan është kultura e egër, barbare, e trashëguar dhe kultivuar ndër shekuj. Është kultura ku gruaja mendohet send, që i takon një burri me të cilin ai mund të bëjë çfarë të dojë dhe sillet si të dojë. Në Gjermani, në vitin 2017, një azilant afrikan, Hussein K nga Afganistani, e përdhunoj seksualisht dhe e vrau një studente gjermane, Maria L, nga Freiburg. Kur kryetari i trupit gjyqësor, i deklaroi atij vendimin gjyqësorë, burgim të përjetshëm ai tha: “Çfarë demokracie është kjo e juaja? Si mund të dënohet njeriu me burgim të përjetshëm për një gjë të tillë? Unë një femër vrava!”

Kjo është kultura e tij barbare, orientalo-patriarkale lidhur me qëndrimin ndaj femrës. Por, sigurisht që jo vetëm personalisht e tij. Është edhe e kombit nga i cili ai vjen. Mjerisht, kombi ynë, është pjesë e kësaj kulture. Shumë nga ne e kujtojmë dramën me titull “Fisheku në pajë” të dramaturgut tonë, Mjeshtër të Madh, Fadil Kraja. Meshkujt e edukuar në mënyrë patriarkale, me një kulturë përçmuese deri dhe armiqësore ndaj gruas, nuk mund ta kuptojnë gruan. Politologu me prejardhje siriane, Taip Bassam, profesor në universitetin e Goetingenit-Gjermani, thotë: “Duket se perëndimorët nuk e kuptojnë dhunën kundër grave në botën islame si traditë të një kulture orientalo-patriarkale. Në Orient, gruaja nuk mendohet subjekt por, thjeshtë si send që, bën pjesë në nderin e burrit. Një ide e

tillë, gëzon një popullaritet të madh edhe tek ne, në kulturën tonë. Ajo që e bën të “padukshme” dhunën tek ne dhe që i jep jetëgjatësi asaj, është frika e denoncimit të dhunës mashkullore nga gratë. Gratë heshtin, nuk guxojnë të denoncojnë dhunën. Nëse rrihet nga burri dhe duken qartë shenjat e dhunës, ajo thotë: “Jam rrëzuar nga shkallët!” Janë faktorë të ndryshëm që ia diktojnë një sjellje të tillë. Sipas kulturës tonë, viktimja femër, në të gjitha, rastet mendohet turp dhe agresori nuk gjykohet, në opinion. Një zakon i tillë, orientalo-patriarkal, ia mbyll gojën gruas edhe në rastet e përdhunimeve seksuale. Ajo, për të mos mbajtur turpin, fshehë dhimbjen, poshtërimin e përjetshëm. Burrrat e dinë këtë gjë dhe i kanë duart e lira në sulmin ndaj grave. Problem botërorë sot është përdhunimi seksual masiv i grave në vendet e luftës. Jemi dëshmitarë të përdhunimeve të tilla në Bosnje, Kosovë, Kongo dhe sot në Siri. Një sjellje e tillë kriminale, ka një motiv krejt tjetër. Lufta është barbarizëm dhe si e tillë, agresori, për të arritur qëllimin, përligj çdo mjet. Përdhunimi seksual i grave është pjesë e taktikave të luftës. Është e organizuar nga lart. Edhe nëse dikush nga ushtarët e forcave pushtuese nuk dëshiron ta bëjë një gjë të tillë, ai është i detyruar. Me këtë, agresori do t'i tregojë viktimës se: “Çfarë burrash jeni ju! Ju nuk mbroni dot gratë tuaja!” Pra, është akt poshtërimi dhe hakmarrje. Me këtë, agresori don të tregojë edhe faktin se, mua më takon gjithçka këtu. Burrrat e grave të përdhunuar, sigurisht që ndjehen shumë keq. Aq keq sa shumë nga ata bëhen gati të hedhin armët dhe të pranojnë vullnetarisht pushtuesin. Përdhunimet seksuale nga agresori arrijnë deri aty sa, aktet e përdhunimit, i kryejnë në prezencë të personave të tjerë, madje edhe të burrave, fëmijëve dhe të afërmeve të gruas viktimë. Duket se, përballë një barbarizmi të tillë, të gjitha organizmat ndërkombëtare, janë të pafuqishme.

Lekë Imeraj
shkrimtar dhe përkthyes

Kolë Delia, Dedë Binaku, Mark Mhilli, Lulash Vuksani, Dedë Mëhilli e të tjerë.

Ju Mark as një herë nuk i imituar as njërin nga ta, nuk i përçmuat, nuk u rebellove edhe kur nuk përpuqeshe mendimet dhe mentalitetin e tyre. Si sekretarë i organizatës së partisë më të madhe të Shoshit, kurë nuk gërvishite në biografinë as njërit ndonëse shumica kishin hije jo të vogla.

Të gjithë moshatarët tuaj do kishin dëshiruar të ishin në vendin tënd. Zilia është pjesë e natyrës njerëzore, por edhe ziliqarëve më cinik e më gjuhë a nuk u le shteg me të shitu as me llafe as me gur.

Ti Mark ishe birë i një burri me shenj, ketë e kam me të dëgjuar nga burrat e vjetër të Pepsuamjve.

Ti Mark, ishe një trevestarë i mirë dhe ketë e kam provuar dhe parë me sytë mijë.

Ke bë dasma e mort shembullor.

Prite, përcolle mikun, shtegtarin, lypsarin, dasmorin, festarin, punëtorin dhe nëpunësit e çdo niveli.

Ti ishe një zot shtëpie i drejt dhe i rreptë, me punët më vështira u kacafyte rroka- roka, ndërtove shtëpi dhe puna të pati gjithkund te mira. Sa punëtorë ishe ta tregonte koshi i drithit, kosheret e bletëve, vreshti dhe vozgat e rakisë e venës, mishi i tharë në tym. Të gjitha këto i realizove me mund, me djersë, me vullnet, jo me tesër partie.

Ti Mark ishe një sekretar babaxhan i drejtë, pa hile dhe avokat i njerëzve të shtresës tende.

Ti nuk bërë as njëherë brigadierin, përgjegjës, magazinierin as normistin, rushfetxhiun.

Ti nuk u bere as një herë servilin, hipokritin, arrogantin, mendjemadhin, as karagozin.

Ti kishe mundësi me dy fjalë gojë të prangosje njerëz, por as nuk të shkoj

në mend.

Ti kishe mundësi të demaskoj publikisht çdo njërin, që nuk ishte në binarë e kohës, por nuk e bërë kurrë.

Ti mbylle njërin sy e njërin vesh ndaj atyre që vinin dorë nga halli në një karabush, në një dorë groshë, në një tas qumësht, në një thes gështenja e të tjera.

Ti kurrë nuk udhëhoqe operacionet për sekuestrimin e një dhie, e një dele, apo e një derri ilegal.

Ti nuk pranove të pije, të haje e ti bije qylyt ndërkohë, që edhe pula e vetme dikujt nuk i dhimbej për ju. Ti ishe burrë i ndershëm e me integritet dhe kurë nuk re pre e gjuetisë së gjësë së huaj.

Disa vite kam punuar mësues te Shkolla e Ndreajve. Jemi pare e takuar shpesh, se të kishim komshi të parë. Më bënte përshtypje sa mirë krasisje e sistemoje hardhitë dhe pemët, sa mirë ngaje qete e prashisje, sa mjeshtërish

dhe elegancë kositje, sa të dashur e bwje rakinë, sa hije të kishte ibriku në tervesë.

Ti pas viteve 90-të as nuk u fshehe, as nuk u bërë kameleon. Ju fute punës më devocion, ndryshove vendbanim e bëre konak të ri edhe më të mirë, me duart tua.

Ti Mark kishe, përvojën urtësinë, drejtësinë dhe zemërbardhësinë të futeshe në rrugën e misionarit, por i the Stop. Unë isha dje ai që isha tani e kanë rrallën të tjerë sekretarw, kryetarw e misionarë. As dje në atë diktaturë aq të ashpër, as sot në ketë pseudodemokraci të shëmtuar nuk e shiblove vetën as një herw.

I vogël si napolon. por jetove e vdiqe me nderë!

Nga **Prelë Milani**

CURRAJ I EPËR VETËZBULOI VIRGJERINË DHE HIRET E VETA RREZATUESE ALPINE

Curraj i Epër, vëlla siamez, i lidhur me një kërthizë me Thethin, shpinë për shpinë me Valbonën, ndërsa më Vermoshin i bashkon e njëjta telepati natyrore. Bukuroshi i fjetur i bjeshkëve tona, gjendet në vazhdimin fundor të pellgut të Nikaj Merturit, i rrethuar vullshëm nga male gjigante, mbi 2000 metër, që formojnë njësinë më të fuqishme të Alpeve lindore dhe nga më të mëdhatë e më të egrat e krejt maleve shqiptare.

Curraj i Epër geomorfologjikisht përfaqëson një luginë më forme govate me tiparet e një amfiteatri madhështor me drejtim nga VP-JL. me arkitekturë tipike të epokës së kuarternarit. Lugina kufizohet në fund, në anë të majtë me majën Bosh (në VP, 2416 m)¹, e cila ngrihet në formë kupole duke formuar ngjyrën hidrografike, trekëndorë mes lumenjve të Nikajve, Shalës dhe Valbonës. Në lindje Grykat e Hapta (2625m lartësi) dhe masivi që të drejton në majën konike të Hekurave (2561 m), ka më shumë pamjen e një blloku të fuqishëm që ngrihet vertikalisht mbi luginën e Currajve. Në perëndim ngrihet vargu pak më i ulët i Çardakut të Kakisë (1853 m, këtu gjendet edhe një nga shpellat më interesante e Kakverrit) që zbret deri në Rrasën e Currajve duke formuar ujëndarësin e lumit të Currajve dhe Nikajve. Në VP të luginës dhe në faqen lindore shfaqte në mënyrë të dukshme morfologjia akullnajore me cirqe të shumtë në formën e lugjeve që zbresin shkallë-shkallë dhe shënojnë fillimin e degëve të lumit të Plasë. Lugina e përroit të Plasë nga ama e saj mes Kakisë dhe Derzave të Boshit, vijon deri te pragu i Drelës, në hyrje të fshatit, duke përshkuar formacionet rreshpore.

Ndërsa në dalje të fshatit, lugina lumore pagëzohet me emrin Curraj, e cila në mënyrë të detyruar ngushtohet nga formacionet solide karbonatike, duke formuar pragu e dytë dhe duke marrë pamjen e një kanioni (Shkëmbi i forcës). Arteria kaltërore vijon të meandrojë mes karbonatikëve deri sa bashkohet me luginën e Kuçit. Mbas bashkimit formohet lugina e vetme e Currajve, e cila ruan tiparet e një "V"-je të gjerë e të thellë deri në hyrje të fshatit Curraj i poshtëm. Aty mbushet me frymë, lirohet duke çarë lehtësisht formacionet rreshpore, zgjeron shpatullat duke formuar zgjerimin e Lekbibajve. Këtu bashkohet dega e përroit të Nikajve, që ka fillimet të burimet e Vranës dhe dega e Currajve duke formuar së bashku lumin e Nikajve me gjatësi 19 km dhe sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 145 km ka².

1 Gjeografia fizike e Shqipërisë. Botim i Akademisë së Shkencave. Qendra e studimeve Gjeografike Tiranë 1991, fq 79 (lartësitë e maleve janë marrë nga i njëjti burim)

2 Gjeografia fizike e Shqipërisë. Botim i

Curraj Epër është një bjeshkë e shkëlqyer panoramike, si kurorë dafinash mbi kokën e pellgut të Nikaj Merturit. Malet e lidhur sup më sup, fusnin në kllapa luginën, puthën me kupën e një qielli kaltërosh, nën hijen e të cilave shtrihen livadhet e Rrajzave, Kodër Demirit, për të vijuar me lugjet paralele Lugu Zajkut, Boshit dhe Koritave. Duhet mbi dy orë ecje të thekshme në rrugë këmbësore nga qendra e Currajve deri tek ato kullosa të



mbuluara me gjithfarë lulësh bukuroshe, që përbëjnë një minierë sa të pasur aq edhe të rrallë botanike.

Në JP të Currajve shtrihen rrafshnalta e lumnume me livadhe pa fund dhe burime përrallore të Pikut që është bukuria, mirësia, jetesa dhe krenaria e Currajve të Epër të mirënjohur si blegtorë të shquar. Livadhinat e Pikut që ngjasojnë me shtrija të papërsëritshme leshi dhe mëndafshi duke formuar një koleksion natyral tepër elegant, dhuratë e begatë e Krijuesit të gjithëpushtetshëm. Një mozaik spektakolar, i gjalluar nga lulet shumëngjyrëshe, plot reflekse xixëlluese qëndisin këndshëm ato shtrija të blerta, të pashoqe. Drethët (luleshtrydhet), mjedrat, qershizat e egra (boronica), manaferrat selepi, xhirokulli dhe kërpudhat janë begati ngjyrash, aromash, shijesh dhe vlerash të bekuara për organizmin e njeriut.

Përroi lumë, që ndanë në mënyrë simetrike dy faqet e luginës është arteria kryesore e kaltër me valë të argjendta që rrjedhë si uverturë e këndshme në blerinat e pashoqe alpine. Ujërr

Akademisë së Shkencave. Qendra e studimeve Gjeografike Tiranë 1991, fq 81,

rrjedhja vjen e shtohet pasi mbledh me dashamirësi të gjitha krojet dhe burimet e prej gurrës së shpellës së lumit atë të Qereshit që gufojnë plot gjallëri prej strukturave karbonatike e flishore me shumicë. Edhe po që statik si shkëmbi, nëse gjendesh në agim në atë breg, njëherazi me rrënjën e rrezeve të diellit, kalon ylberin e bëhesh romantik, delikat. Çfarë pëshpëritë kjo valë e acartë, çfarë është kjo romancë elektrizuese që

gjak zaptishë të huaj që nuk mundën të ngulin kurrë këmbë në këtë fole shqipesh krenare.

Në breg të këtij lumi, afër kishës për karshi, në verë të viti 1915, Gjelosh Rama në krye të vullnetarëve të Curraj Epër shkroi një epos qëndrese së bashku me Kukel Nduën, Sylë Avdinë, Mark Hasanin, Balec Gjonin. Në kushtrimin e në poteren e Currajve të Epër fluturuan edhe Prelë Tuli e Tunxh Myftari edhe Mark Sadiku e Shytan Brahimi edhe Mark Alia, Dedë e Sadri Trimi, edhe Nikë Musa e Zhujë Avdyli³.

Ora e Nikajve, e remtë dhe idhtë si pika, shytë rrufeje prej Majës së Kakisë dhe i bëni gjëmën ushtrisë serbo-malazeze në Curraj të Epër. U bënë fli në këtë sfidë fatosat Nikë Delia, Sadri Trimi, Ali Haka, Sejdi Myftari, Gec Prendi, Kamer Prela dhe Zhuj Avdyli.⁴

Curraj Epër ka klimë tipike malore, me dimra të ashpër, me reshje të shumta bore dhe me verë relativisht të freskët. Temperatura mesatare vjetore lëkundet nga 8-11 gradë C dhe sasia mesatare e reshjeve 2763 mm (Qerç, Mulaj). Pjesa më madhe reshjeve të dimrit dhe pjesërisht ato të fund vjeshtës e fillim pranverës bien në formë bore. Nga reshjet e bollshme të shiut por edhe të borës niveli i prurjeve të lumit të Currajve është i lartë. Nga niveli i prurjeve gjeografet e kanë quajtur vëlla të Kirit dhe nga regjimi, tezak i Valbonës. Në këtë lumë, me ujë si loti, jeton trofta pikaloshe, tipike e ujërave të ëmbla alpine.

Trupi i saj është i mbuluar nga pika të kuqe të vogla me hije të gjelbër në kafe. Përmasat e saj variojnë nga 10 cm deri në 50 cm

Kjo luginë mbulohet nga një florë trekatëshe, që fillon me dushkun, dominon ahu e më pak pisha. Mbi brezin e ahut dhe të pishës si shami rrezedhitëse valëviten kullotat e pasura alpine.

Këtu takohen bimë të periudhës akullnajore (reliktet glaciale) me bimë të shumëllojshme dhe interesante Fauna e Currajve është e pasur dhe e larmishme, identike si e Thethit, Valbonës dhe Vermoshit, disa lloje gjitarësh, disa dhjetëra lloje shpendësh folenizues, zvarranikësh dhe amfibësh. Rëndësi paraqesin gjitarët dhe shpendët e lidhur me pyjet e larta dhe ekosistemet malore alpine. Ndër gjitarët më të mëdhenj të parkut janë: Ariu i murrme, ujku rrëqebulli çakalli, dhelpra dhia e egër, kaprolli, derri i egër etj

Fshati shtrihet prajshëm në dy anët e

3 Dodë Progni, Zef Deda "Nikaj Merturi vështrim historik" Shtypur në Shtypshkronjën "Shtjefni" viti 2003, fq 162-163.

4 Dodë Progni, Zef Deda "Nikaj Merturi vështrim historik" po aty.



si damar të një trupi të shëndetshëm që ushqejnë e mbajnë njomë bimësinë e këtij vendi që edhe në pikun e verës shkëlqen plot gjelbërim.

Ky lumë i pastër shpesh është larë me

kësaj luginë të mahnitshme, me 870-900 m mbi nivelin e detit. Tokat në të dy anët e lumit janë sistemuar me kujdes mbi atë litologji tarracore të formuar nga materiallet e shumta kokuvo-deluviale. Shpatet kodrinore janë të veshura me gjelbërim, relievi aty- këtu përthyer me ulje e ngritje deri në lartësim në kreshta e curra të mprehtë duke krijuar një mozaik natyral madhështor plot ngjyra e shkëlqim që për disa muaj të vitit mbytet në një det kristalor bardhësie.

Vera është një stinë shpërthyes dhe dorëlëshuar në bukuri. Bujaria e saj derdhet me hijeshi kudo në Curraj të Epërm duke sjellë gëzim për syrin dhe shpirtin e njeriut. Ajri i bjeshkëve, parfumi i lulëzimit, flladi i ahut, aroma e pishës janë ledhatimi, puthja dhe prehja ëndërrimtare e trupit dhe e shpirtit.

CURRAJ EPËRM NË KOMA I THOTË "JO" VDEKJES

Mbizotërojnë shtëpitë e gurta, kryesisht dy por edhe tre kate të larta, me qoshe të skalitura estetikisht më dekoracione iliro-paganë në harqet e dyerve dhe dritareve. Rrok Zojzi në ekspeditën e tij studimore në vitin 1956 ka skicuar dhe përshkruar banesën tipike alpinë të Currajve të Epërm, ku si veçon shtëpinë e Plumb Marashit (muri, qoshet me gur të latuar, çatia me dy u-ja shumë të pjerrëta, mbuluar me dërrasë⁵

Të gjitha me çati piramidale prej dërrasë pishe, me shkallë përjashta e krevate druri në të shkuarën. Banesat kanë formë drejtkëndëshi dybrinjnjëshëm, dy prej tyre përfundojnë me gungë në formë trekëndëshi dhe ngrihen në lartësi deri tek kulmi duke u dhënë hijeshi, madhështi dhe përshtatshmëri fine me natyrën. Nga lartësitë e qafave përmbi, shtëpitë e Currajve ngjasojnë si koshere bletësh në miniaturë të shpërndara në blerim si yjet në qiellin pa re.

Rrezet e para të mëngjesit dhe drita e zbehtë e hënës janë vegim fotozhenik i pashoq për syrin e njeriut që nuk ngopet duke pa me lakmi. Në prag të viteve nëntëdhjetë të shekullit XX kishte rreth 150 shtëpi, të cilat fatkeqësisht për më se 25 vite kanë mbete shkretë.

Në qendër të fshatit gjendet kisha që daton me vitin 1887, e cila i ka mbijetuar herezisë ateiste dhe asaj migrative. Aty pranë gjendet shkolla e vjetër prej nga kanë dalë filizat e shëndetshëm të mësuesve, inxhinierë, agronome, doktorë, veterinerë, oficerë, juristë dhe intelektual më profil të larte shkencor, me tituj e dekorata. Vatra që ushqente me dije breza të tërë nxënësish, sot ngjason si koshere e një blete të braktisur. Në kontrast të thellë bashkëjeton peizazhi i blertë më gjithçka të ndërtuar nga njeriu në rrënim pa fre. Braktisja e këtij vendi ka ndodhur për disa arsye: Shumica e Currajve kërkuar një jetesë më të mirë, shumë të tjerë kanë qenë të detyruar të largohen, pasi të gjitha qeveritë jo vetëm e kanë harruar por as nuk e dinë se ku ndodhet kjo mirësi e struktur në sqetullën e maleve, ndërkohë që hireve të tij i kanë kënduar, që në fillim të shekullit 20-të Franc Nopça, Karl Steinmetz, Edith

⁵ Rrok Zojzi "Shala ,studim etnografik i daktilografuar 1956 . Arkivi i Muzeut Historik Shkodër, fq, 39.



Durham, për të vijuar me At' Z. Valentini, At B. Palaj, Rr. Zojzi etj.

Në mes të fshatit, pranë urës që bashkon dy anët e lumit të Currajt, në lagjen Nikbibaj, gjendet shtëpia Kol Dedës. I ka mbetur emri "Kulla e Ngujimit", ku në fakt ka pas krejtësisht pamjen e një pingu këshqullor vendosur mbi një curr gëlqeror afërsisht 15 m e lartë, e cila thuhet se u ndërtua rreth viteve 1840-1850. Kulla ka qenë trekatëshe, tashmë e këputur në kryq dhe e shndërruar në

gjysmë rrënojë, e konsideruar si njëra nga gjiret e gurit më të vjetra të krejt krahinës dhe binjake me "Kullën e Ngujimit" në Theth

Krejt afër Kishës, te parapara nga perëndimi gjenden varrezat ku prehën homerikët e vjetër, dëshmia më autentike e burrnimit shekullor të kësaj bjeshke. Aty të skalitur në rrasa e kryqe gjenden emrat e pushkatarëve të shquar si Gjelosh Rama, Kolë Salih, Kolë Ademi e Shan Zenuni.

Në atë mëzlis rrafshit pushojnë dijetarë të filozofisë popullore dhe ekspert të kanunit si Kukel Ndou, Pal Nika, Mark Elezi, Balc Gjoni, Mark Hasani, Avdi Sylja, Gjon Alia, Isuf Sadiku, Kolë Leka, Grimc Dema etj⁶. Informatorët e devotshëm Martin Gjoni, Kolë Leka, Brahim Gjura, Mark Qerimi kanë zënë strugën duke biseduar me etnografin syzues Rrok Zojzi⁷

Në ato varrë gjendet galeria shumë ngjyrëshe e tatave e vjetër, burra fisnike, bujare, trima, si zana, krenar e të bardhë në shpirt. Ata janë kurora me vezuluese, ku shndrisin traditat tona të vyera, zakoni i odës së burrave, kënga dhe lahuta, mrizi i zanave, kushtimi kënga maja krahut dhe gjëma e burrave. Ato varre të lëna shkret mbajnë brenda dhe ruajnë me fanatizëm rapsodët më autentik të epositon të vjetër, të cilëve At B. Palaj "u volli "vargjet e dëlira në buzë duke i mbledhur si bazilika të çmuara në visaret e kombit. Te blini i atyre varreve cicëron si zog këngëtar edhe shpirti i rapsodit të çmuar Zef Avdia, i cili fizikisht prehet në tjetër vend varresh.

Ndër ato varre prehën bujarët e mëdhenj të fisit që pritën e përcollën më zemër të bardhë, tërvesë gomilë që i falë miku nderë, respekt, e ngrohtësi në atë masë sa për të gëzoheshin edhe trarët e shtëpisë

I lehtë është dhe i atyre varreve të lëna shkretë nga anarkia tranzitore, për bujqit punë mirë që nuk lanë pëllëmbë vend, pa punuar sistemuar e futë nën ujë. Ata çelën tokë re të në rrasë gjallë, ndërtuan mure prej gurësh ciklopik të lara tre katër bojë të shqyer me thonj nga shkëmbi, për ti mbrojtur nga erozioni dhe zemërimi i përrënjeve të çmendur të vjeshtës. Në ato ara e kopshtie ku gjallonin bimët kokulura me nga dy kollomoq, ku grosha shkëlqente si inxhi dhe kërtolla (patatja) behej e shëndetshme sa një opingë azgani, e kungujt vareshin si shtama ndër stamije. Sot kamë mbirë ferrat dhe drizat. Muret arave janë shkaperderdhe, dhe kullat per bri tyre ngjasojnë si plaga dhëmbzgurdudhuara të molizura në shtratrin e rrekosur të vdekjes.

Në ato varre bëjnë pushim e pasosur tufë mëdhenjtë e moteve të dhive, lopëve e kryesisht të deleve prirë Kolë Leka e Mark Preka nga më të zëshmit e alpeve tona. Delet dhe qengjat e Currajve kur hynin në pazarin e Shkodrës apo të Gjakovës, ndonëse përshkonin 4-5 ditë rrugë, "korsinin "bagëtitë e të gjitha trevave të tjera. Gjëja e gjallë ka qenë pasuria ma e madhe, kullosat e mira të bjeshkëve ishte bekim për këtë fshat që ka" notuar" në amel, tyle, djathë e mish. Edhe më i varfëri i këtij katundi, ndoshta ka vuajtur për gjeje e bukë, për veshë, shtrojë e mbulojë, por jo për bulmet. Djathin e Pikut duhet të jesh gastronom ta përshkruash, duhet të kesh duart si stanicat acare bjeshkatore ta ziesh.

Nga Prele Milani,

Vijon në numrin e ardhshëm.

⁶ Inxh Martin Gecaj Gazeta "Nikaj-Mërturi" Nr 5. Viti 2005.

⁷ - Rrok Zojzi "Shala studim etnografik i daktilografuar 1956 . Arkivi i Muzeut Historik Shkodër, fq, 36, 38, 40

JAM KRENARE, SI MBESË E DUKAGJINIT

- NJË TELEFONATE NGA PËRTEJ OQEANIT -

Disa ditë më pare, në Kolorado të SHBA ndërroi jete një grua e nderuar, një intelektuale e shquar, bijë e Shkodrës, Geti Fistani (Franja). Vdekja e saj na pikëlloi, sepse qe një nënë shembullore e dy djemve, Eugenit e Julianit; një bashkëshorte e denjë për profesor Tonin Fistani, e bija e një gruaje të madhe e të mirënjohur në Shkodër e në gjithë Shqipërinë, veterane e Luftës Nacional Çlirimtare, me një angazhim të gjatë në jetën politike e shoqërore, në mënyrë të veçantë për emancipimin e femrës shkodrane, me emrin Zina Franja.

Geta e mbajti emrin, nderin e lavdinë e nënës së saj. Ajo, familjarisht ka shumë vite, që ka emigruar e detyruar, sepse pedagoges së talentuar ju shkurtua vendi i punës në Universitetin "Luigj Gurakuqi", ashtu dhe bashkëshortit të saj, pedagogut e shkencëtarit Tonin Fistani.

Geti, në Shkodër lindi dy djem, Eugenin e Julianin, të cilët u rriten me kujdesin dhe dashurinë e gjyshes së tyre. Këtu, ata u shkolluan me rezultate të shkëlqyera, për ta përfunduar arsimin e lartë në Kolorado, ku dhe u punësuan e krijuan familjet e tyre.

Geti, provoi lumturinë e saj, jo vetëm si nënë, por edhe si vjehrrë nga dy rejat e saj shumë të respektuara e të dashura për



te, si gjyshe, nga mjalti i mjaltit.

Geti ishte dhe mbesa ushtarakut të talentuar, Admiralit Mark Plani, Shefit të Shtabit të Flotës Shqiptare.

Siç u theksua më lartë, ajo emigroi duke lenë në vetmi nënën e saj, Zinen, me dhimbje në zemër të thyer pasi e përcolli me pjesëtarë të familjes saj, me të cilët bashkëjetonte, por që pas kësaj u detyrua të kalojë në vitet e pleqërisë në vetmi deri sa e mbylli atë, në muajin korrik të vitit 2013. Gjate këtyre viteve, Geti vinte shpesh here në vendlindjen e saj, për t'u çmallur me Zinen, për ti plotësuar çdo nevojë deri dhe shërbimin e një gruaje deri në ditët e fundit të saj. Por për shkak të gjendjes jo të mirë shëndet-

tësore u vështirësuan lëvizjet e saj deri në pamundësi. Zina u përballë me situatë të re, jo vetëm për veten e saj, për shkak të moshës, të sëmundjeve e vetmisë, por asaj ju shumëfishua dhimbja për vajzën e saj të vetme, që nuk po i printe mbare shëndeti. Megjithatë Zina, simbolizonte njeriun me karakter të forte, me kuraja, me besim në të ardhmen.

Geti, grumbulloi forcat për të bërë vizitën e fundit te nëna e saj, duke u ndare prej saj, pasi ajo ndërroi jete dhe duke udhëhequr gjithë ceremoninë e përcjelljes për në banesën e fundit, duke pritur e përcjell me dhjetëra e dhjetëra shoke e miq, dashamirë të familjes Franja, pjesëmarrës në këtë ceremoni.

Para disa kohësh, Geti më mori në telefon nga Koloradoja si një shok e dashamirë i kësaj familjeje, për të shprehur disa vlerësime jo vetëm për nënën e saj, por edhe për shokët, miqtë e dashamirësit e shumte të Zines, të cilët nuk e braktisën asnjëherë atë.

Ajo, shprehur vlerësime të mëdha për Shoqatën Atdhetare "Dukagjini" dhe në veçanti për kryetarin e saj, Ndue Sanaj, për vlerësimet që i ka bërë nënës së saj, dhe me këtë rast, tha: "Jam krenare, jo vetëm për nënën time, por dhe për vendlindjen e saj, Planin e Dukagjinin

dhe unë si mbese e kësaj zone, me aq shume tradita, me moral të lartë e cilësi njerëzore të radha. Respekt e mirënjohje të thellë për të gjithë! Ajo shprehu respekt e mirënjohje për të gjithë banoret e pallatit, ku nëna e saj kaloi vitet e fundit të jetës, njerëz të mirë, dashamirë e shumë njerëzor. Dera e shtëpisë së Zines ishte e hapur gjate gjithë ditës e ato hynin e dilnin çdo kohë.

Mirënjohje e respekt për familjen e Mark Bobnajt, për kujdesin e vijueshëm, që tregoi për Zinen, që nga përgatitja e ushqimit dhe një pjesëtar i saj do të flinte me te, në shtëpinë e saj!

Mirënjohje të veçante, për një grua, me emrin Mrike Masrudin, që u vu në shërbim të saj, në shërbim të Zines, dy vitet e fundit të jetës së saj!

Mirënjohje e respekt për kushëririn e nënës sime, Prel Kroj, me bashkëshortin e tij, Mrine, të cilët herë pas here rrinin me nënën Zine dhe u interesuan aq shume për të!"

Duke shprehur edhe njëherë dhimbjen e thelle për këtë bije të shquar të Shkodrës, e cila ndërroi jetë atje, në Kolorado të SHBA, në fund të vitit të kaluar, ngushëllojmë bashkëshortin e Getit, shkencëtarin e shquar e birin e Shkodrës, Tonin Fistanin, dy djemtë dhe familjaret e saj, për këtë humbje të madhe, të rende e të parakohshme.

Ndoc Grimaj

ÇELËSIN E HARMONISË FAMILJARE E KA NË DORË BINOMI NUSE – VJEHRRË

Ndoc Grimaj

Thonë, që harmonia familjare, është pasuria më e çmuar, që mund të ketë çdo familje. Nëse sigurohet kjo, roli vendimtar është e grave, binomit nuse – vjehrrë.



Për të shkruar diçka rreth këtij problemi më nxiten dy letra, të shkruara në kohë të ndryshme, të cilat i gjeta në shtyp së bashku me disa prononcime, të katër grave intelektuale shqiptare.

Thelbi i kësaj teme ka të bëjë me statusin, të cilin ka gruaja si shpirti i shtëpisë, në saj të cilësive të saj, si tepër humane në marrëdhënie me njerëzit. Për të mbajtur ose për të justifikuar këtë status, ndihmojnë këto dy letra, që po u referohem.

Letra e parë, është e mbretëreshës së Rumanisë, Karmen Sylva, e cila lindi në vitin 1843 dhe vdiq në vitin 1916. Ajo ju drejtohet grave familjare me dhjetë porosi, të cilat janë aktuale në çdo kohë. Pra, edhe për ditët e sotme.

Po veçoj më kryesoret:

-Mos hap sherr kurrë edhe sikur të kesh shkak-pa pritur, mbaj qetësi dhe të jesh e sigurtë, se do të dalësh e fituar. Femra dallohet për durimin që ka, sepse ka përgjegjësinë e shtëpisë.

-Mos harro, se je bashkëshorte e një njeriu dhe jo i një Perëndie. Prandaj mos u mërzhit me huqet e tij, porosiste ajo.

-Mos kërko nga yt shoq "mrekulli" më shumë, se sa ka fuqi. Kjo do të thotë, që t'i shtrish këmbët sa e ke jorganin.

-Po të shikosh, se burri yt s'ka zemër, mos harro se ka stomak, ka bark. Kënaqe ketë dhe të jesh e sigurtë, se do t'ia zaptosh dhe zemrën.

-Kujdesu, kur të jepet rasti, të shkojë mendimi i burrit. Kjo, atë e lartëson dhe ty nuk të dëmton.

-Edhe në grindjen më të rreptë, s' duhet ta lëndosh tët shoq as me fjalë.

-Nderojë, sidomos nënën e burrit tënd. Mos harro, se atë e ka dashur më parë yt shoq.

Këto dhe të tjerat porosi, nuk kanë të bëjnë me atë, që të ulet koka, përkundrazi ato ia rrisin vlerën çdo gruaje.

Ajo, që donë e dashuron burrin e saj, me të vërtetë don edhe prindërit e familjen e tij. Në këtë mënyrë rritet personaliteti i saj.

Aktori i famshëm anglez, Hjuzh Grent, kur u pyet, se çka vlerëson më shumë të një grua, ai u përgjigj shkurt: "Personalitetin! Nuk më intereson fare aspekti fizik, mjafton, që ajo të jetë e bukur në shpirt!"

Letra e dytë ka të bëjë me marrëdhëniet nuse-vjehrrë, nga më të vështirat e delikate, shkruar nga një nuse e re e shkolluar, me arsim të lartë, botuar para disa ditësh, në gazetën "TEMA". Letra i drejtohet vjehrrës, e cila është e shtruar në një spital. Ajo fillon "E dashura nëna e burrit tim, se vjehrrë s' të shkruaj dot!" dhe vijon: "Isha vetëm 21 vjeçe kur erdha në shtëpinë e burrit. As e madhe për të kuptuar përgjegjësinë e një martese, por as e vogël, për të më munguar respekti, si çdo nuse, që ka frikë nga e panjohura, se

çfarë e pret në shtëpinë e tij.

Edhe pse burrin e dua shumë, e dashuroj me gjithë shpirt, më shumë se jetën time, unë ty të respektoj e të kam në zemër, direkt pas nënës sime, por nënë të them me gojë plot dhe ja pse?!

Ti ke qënë aty për mua, kur unë s'dija të zija asnjë kokërr vezë, kur laja ballkonin me shtupën, që laja dyshemenë brennda, ti ke qënë pranë meje edhe kur isha me temperaturë, edhe kur përballoja me vështirësi dhimbjet e shtazënë e të tjera e të tjera.

Ti sot nuk je ajo, që ishe, kur erdha në këtë shtëpi. Moshë e bën të veten, jeta të ka lodhur e unë do të jem pranë teje në çdo kohë. Sado që të bëj për ty, është shumë pak para asaj që keni bërë ju për mua. Nëse unë jam një grua e vlefshme për familjen, për burrin e fëmijët e mi, merita kryesore është e jotja. Unë jam personi më me fat, që jetoj me ty. Të duam, që të na kthehesh sa më shpejt. Po të jem pa ty unë, do të jem e vetme në shtëpi. Ti e din, se aty mungon shtylla e harmonisë familjare".

Këtu përfundon letra, e cila më emocionoi dhe më nxiti t'u referohem edhe disa grave të shquara, të cilat rreth një tryeze të rrumbullakët dhanë përvojën e tyre në realizimin dhe funksionimin më normal të binomit nuse-vjehrrë.

Këngëtarja e mirënjohur, Anita Take: "Fiton Vjehrra", ende e mbaj mbi kokën e krevatit tim. E kam dashur shumë vjehrrën dhe kam qënë me të deri në fund të jetës. Më kujtohet, që Agimi (i shoqi) më thërriste "Lule"; ndërsa ajo më thërriste "Lulishte" dhe më thoshte, të thërras kështu, se jeni më shumë se një lule. Jetën time e kane ndihmuar pa mase sytë e vëmendshëm dhe duart e shkathhtë të kësaj gruaje të mrekullueshme. Ndjehem

dhe jam pjesë e dashurisë së saj, siç është edhe ajo pjesë e dashurisë sime".

Intelektualja Nora Malaj, thekson: "Ajo, që unë vlerësoj dhe adhuroj te vjehrra ime është, se asnjëherë nuk është merret me gjëra të vogla dhe asnjëherë nuk ka shfaqur ndjenjën më të vogël të xhelozisë apo të pabarazisë".

Në vijim edhe një vlerësim nga një grua e madhe, Hillari Klinton, për këto marrëdhënie, nuse – vjehrrë: "Unë e kam kuptuar nënën e Billit, se ajo që kishim të përbashkët ishte më e rëndësishme, se ajo që nuk përputhej. Të dyja donim të njëjtin njeri, Billin".

Urtësia popullore, thotë: "Kur të gjesh princin tënd mos harro mbretëreshën, që e lindi dhe e rriti atë!"

Nusja me mend e falënderon vjehrrën e saj, me motivin e këngës "Ti ke rrite sokol për mua!"

Në mbyllje të këtij shkrimi, për një grua gjermane, e cila u martua me një student shqiptar, në Moskë, kur studioinin bashkë i quajtur Ilmi Bejko dhe ajo kaloi 37 vjet në Shqipëri. Nuk pati fëmijë dhe pas vdekjes te të shoqit u kthye në vendlindje, në Gjermani. Ajo quhej Voltranda Tunger (Bejko). Ajo shkroi një libër, me titull "Çapitjet e mia nëpër Shqipëri", nëpërmjet së cilës përshkruan jetën e saj. Një kapitull ja kushton vjehrrës së saj. Ja, se si e vlerëson atë: "I kam ngritur asaj një përmendore në zemrën time, që s' do mund ta rrëzojë. Nga do që shkoj më ndjekin kujtimet e saj. Vjehrra ime ishte grua e veçantë. Ajo ishte shume tolerante. Më thoshte: "Ç' ka qënë ajo që ka lindur këtë vajzë?!"

FREDERIK RRESHPJA, TEK PORTA E VDEKJES

- ME RASTIN E PËRVJETORIT TË VDEKJES SË MJESHTRIT TË MADH, FREDERIK RRESHPJA -



Moikom Zeqo

Në mëngjesin e funeralit të Frederik Rreshpes, u nisa herët nga Tirana për të qenë i pranishëm në funeralin e mikut tim.

Kishte ardhur nga Durrësi me makinë vëllai im i vogël që quhet Frederik, i cili e njihje shumë mirë Frederikun poet, kishte kujtime me të, sepse kishim qenë bashkë shumë herë.

Ishte një mëngjes madhështor dhe gati i artë, si një lak kohor i çuditshëm i ndërimit të kohërave.

Gjatë gjithë rrugës për në Shkodër, mendoja për muzgjet e zymta të Rreshpes.

Në ka poet që u ka kënduar muzgjeve, është Rreshpja. Në ka çast të kohës që artikulohet në muzg, është pikërisht vepra lirike, e patjetërsueshme e Frederik Rreshpes. Po shkoja drejt fundit të jetës së tij, drejt çastit të mbramë të mikut tim të trishuar dhe të guximshëm.

Drejt Shkodrës, për të cilën Migjeni i madh ka thënë: "Shkodra, dashnorja eshekujve".

A ishte Frederik Rreshpja dashnori më i fundit dhe më i vërtetë i Shkodrës?

Pa dyshim.

Nuk kisha dilema dhe qeshë çuditërisht i qetë.

E dija se vdekja e Frederikut ishte paqja dhe qetësia e tij.

E dija se nuk do të kisha më shqetësime, as situata të paparashikuara prej tij.

Ai vetë e kishte mbyllur sagën e tij të pabesueshme dhe plot paradokse tokësore.

Ora 9 e mëngjesit.

Kapërceva portën e shtëpisë së tij (porta e vdekjes, të cilën ai e kishte ndërruar), pa asnjë frikë, pa asnjë shqetësim, pa asnjë apologji, pa asnjë klithmë të brendshme.

I tillë ishte miku im.

Si Sokrati i vjetër që jetoi keq, që ishte tmerrësisht i qetë përballë vdekjes.

Në ka patur njeri që nuk e ka urreyer vdekjen, por e ka kërkuar, ishte pikërisht Frederik Rreshpja.

Shtëpia karakteristike e Rreshpajve.

Kam hyrë në portën e kësaj shtëpie që në vitet '60 të shekullit të kaluar.

I kisha njohur të gjithë pjesëtarët e familjes, madje edhe ata që nuk janë më.

Kishin kaluar vite të shqetësuar, unë nuk isha më i ri. E njihja mirë oborrin, fizionominë e shtëpisë, mobiljet e saj qindërçare.

Kisha fjetur shumë herë në këtë shtëpi, ashtu si edhe Rreshpja kishte fjetur shpeshherë në shtëpinë time në Durrës, kishte ngrënë bukë nga duart e nënës sime të ndjerë.

Të gjitha këto i takonin tashmë kujtesës.

Kujtesa ishte ajo që na ngurtësonte çdo gjë.

Por kujtesa nuk mund të identifikohet me vdekjen.

Kujtesa nuk mund të jetë identike me fosilet.

Nuk dija, asgjë nuk më alarmonte në lidhje me kujtesën. Veçse përplasja ballin tim në kujtesë.

Hyra në dhomën ku ishte vendosur arkivoli, mes arkivolit ishte miku im i përkorë dhe i qetësuar më në fund.

nuk e kishte më kapelen e tij proverbiale.

Të dy kishim mbajtur kapele.

Shpeshherë na ngatërronin për shkak të kapeles.

Sa herë i kam blerë kapele Frederikut.


Ai e humbte shpesh atë në kafenetë e Tiranës.

Edhe unë mbaja kapele si ai, por nuk e humbja nëpër kafene.

Ja një dallim i vogël.

Dikur i kisha folur për poetin e madh portugez Fernando Pessoa. Pessoa kishte thënë dikur se nëse mund të shohësh ndonjëherë ndonjë njeri të heshtur me kapele në ndonjë rrugë të humbur, ai do të ishte patjetër një poet.

Rreshpja ishte pa dyshim një poet.



E kishin veshur me një kostum të ri dhe me këpucë të reja, një repertor i vdekjes, asnjëherë nuk ishte veshur në këtë mënyrë në të gjallë.

I shtrirë në arkivol, ishte identifikuar me një gjumë, dukej se nuk kishte ndër mend për gjësend, por vetëm të flinte. Pagjumësia e tij nuk e torturonte më.

Pagjumësia e tij qe diku, por jo tek ai vetë.

Frederik Rreshpja kishte mbyllur sytë,

Takova vëllezërit e tij që kanë mbetur gjallë: Kelin dhe Gjonin.

Prisnin njerëzit.

Vinin pa pushim njerëz, patjetër edhe malësorë nga Dukagjini.

Disa gra që nuk i kisha takuar asnjëherë, rrinin pranë arkivolit të të vdekurit.

Befas ra telefoni im celular.

Mori Sadija, gruaja e Dritëro Agollit.

Pastaj bisedova në telefon me vetë Dritëro Agollin, i cili m'u lut t'i jepja ngushëllime familjes së Frederik

Rreshpes, këtij poeti të çuditshëm dhe të vërtetë.

Dritëroi kishte dërguar edhe një telegram në emër të familjes.

Në librin e tij të parë "Rapsodi shqiptare", Rreshpja kishte edhe një poezi ku fliste për "një gajde që tingëllonte në hapësira si zëri popullor i Dritëro Agollit".

Frederik Rreshpja e donte Agollin, por qe i ndryshëm si poet.

Agolli ishte i vetmi nga Tirana që mori në telefon për Rreshpen.

Askush tjetër nga shkrimtarët e tjerë të Tiranës, nuk e bëri këtë gjë.

Pse vallë nuk morën shkrimtarët e tjerë nga Tirana, pse vallë nuk çanë kokën për vdekjen e Rreshpes?

Frederik Rreshpja nuk kishte nevojë për ata.

Vdekja e Frederik Rreshpes, kishte një autonomi të brendshme dhe një dinjitet më të madh se kinse-telefonatat e të tjerëve.

Le që nuk duhet harruar, ai tashmë ishte i vdekur, për të ishin të huaj pafundësisht telefonat, madje edhe telegramet.

Ai tashmë nuk ndiente më asgjë.

Ai tashmë ishte në pragun e portës së vdekjes, ai kishte dorëzuar shqisat e tij, nuk mund të shkruante më poezi, poezitë të cilat i kishte shkruar, ishin të vetëmjaf-tueshme dhe të patjetërsueshme.

Vëllezërit e Frederik Rreshpes, më konsideronin njeri të familjes dhe në prisja ngushëllimet së bashku me ata.

Por kjo nuk kishte shumë rëndësi.

Të njëjtën gjë e kisha bërë në vdekjet e motrave të Frederikut, Netës, Ciatës dhe Pashkës.

Duke pirë duhan, bisedonim për gjithçka, por jo për vetë Frederikun.

Në orën 13.00, do ta conim arkivolin me trupin e të ndjerit në mjedisin e Teatrit të Shkodrës për homazh.

Për këtë, kishte ngulur këmbë shkrimtari i shquar i Shkodrës, serioz dhe i pëpur, Skënder Drini.

Ndërkohë, në oborrin e shtëpisë së Rreshpajve, shkëlqente Dielli.

Lëkundeshin në erë degët e një druri të madh të dafinës, bimë që ishte mbjellë para 6 viteve në këtë shtëpi.

Pranë dafinës, rrëzëllitej në dritë shega e vjetër, që e kishte mbjellë vetë Hilë Mosi.

Kisha biseduar shumë herë me Frederik Rreshpen për këtë shegë të çuditshme dhe delikate.

Nuk kisha arritur kurrë të kuptoja pse pikërisht kjo shegë ishte mbjellë në këtë vend.

Befas, erdhi dhe na takoi në ceremoninë mortore plaku i vjetër shkodran 80-vjeçar, Tomë Sheldija.

Ai e dinte shumë mirë historinë e shegës.

Sipas tij, Hilë Mosi e kishte mbjellë atë, i frymëzuar nga një poezi e Karduçit.

Ja edhe vargjet e Karduçit, që Sheldija e kishte shkruar në një copë letër, të cilën ma dha mua:

“L'albero e eni tendevi,
la pergoletta mano,
il verde melograno;
dai bei vermigli fior ...”

Domethënë, pema e mbjellë nga një dorë delikate, ishte një shegë jeshile e lulëzuar nga farëra të mira.

Kurse vetë Hilë Mosi, kishte bërë një poezi të cilën e kishte quajtur “Shegës së kopshtit”, ku thoshte:

“Ka kohë, o shegë, që të mbolla,
e ti je rritë ...”

Sa herë kisha biseduar me Frederikun për këtë shegë të çuditshme dhe gati inkadeshente.

Shega do të mbijetonte, por Frederiku jo më.

E kam ditur gjithmonë se shega ka qenë një simbol i mbijetesës, edhe në kohën e Solomonit që përmendet në Bibël.

Sa herë vija në shtëpinë e Frederikut, e merrja një kokërr shegë për ta ruajtur në shtëpinë time në Durrës.

Këto janë simbole të kujtesës krej naive, por që tashmë më zhvlerësoheshin prej vdekjes së mikut tim.

Mendoja që do të vinin shumë njerëz

në funeralin e Frederik Rreshpes.

Por nuk ndodhi kështu.

Nuk di ta shpjegoj këtë gjë, por vetëm ta konstatoja.

Në orën 13. 00, e çuam trupin e tij në mjedisin e Teatrit “Migjeni”, për kinse t’i bënin nderimet e fundit qytetarët e Shkodrës. Përshpëritej se do të vinte kinse “një njeri i madh” nga Tirana, kinse do të vinte Kryetarja e Kuvendit ose dikush tjetër.

Askush nuk erdhi nga Tirana. Ishin vetëm disa miq që rrinin të heshtur.

Shteti u tregua indiferent dhe i pamëshirshëm për shkrimtarin e vdekur.

Nuk kishte si të ndodhte ndryshe.

Kjo gjë ishte shumë e kuptueshme dhe e lexueshme.

Shkrimtari i shquar nga Shkodra, Skënder Drini mbajti një fjalë të shkurtër, tha për Rreshpen se ai ishte “një fortunë njerëzore”.

Arkivoli me trupin e Frederik Rreshpes, e çuam në varrezat e Rrëma, ku është varri dhomë i Rreshpajve.

Para disa muajve, qemë në këtë vend, në varrimin e Pashkës, motrës së madhe të Frederikut.

Tani, përsëritja e ceremonialit ishte për Frederik Rreshpen. Në kapelen mortore të varrezës së Rrëma, një priift i ri mbajti ritualin e domosdoshëm.

Njerëzit ishin të heshtur, por jo aq të pikëlluar sa ç’duhej të ishin.

Nuk ishin më shumë se 80 njerëz në këtë ceremoni.

Nga Tirana, kishte ardhur vetëm shkrimtari Shpëtim Kelmendi, si edhe poeti Myftar Gjanaj; kurse shkrimtarët e Shkodrës nuk ishin të pranishëm.

Përse vallë? Përtonin të vinin në varrezat?

Po ç’janë këta shkrimtarë përpara Frederik Rreshpes?

Nuk kanë mësuar ende të nderojnë të vdekurit e mëdhenj?

Nëse nuk kanë mësuar të nderojnë të vdekurit e mëdhenj, atëherë përse shkruajnë?

Momenti i fundit: Kalojnë njerëz të familjes për t’u ndarë me të ndjerin.

Kalova edhe unë, u përkula dhe e putha në ballë Frederik Rreshpen.

Balli i tij ishte tmerrsisht i ftohtë, akull, akullnajë, antarktidë.

Balli i tij, truri i tij, që kishte krijuar poezitë më të çuditshme dhe më të papërsëritshme.

Në kishte pasur ndonjëherë thesar Frederik Rreshpja, ishte pikërisht truri i tij.

Të gjitha të tjerat, i kishte pasur të zakonshme, madje të papëlqyeshme.

Ishte i shkurtër, i vogël, ndonëse ai thoshte që në fëmijëri “kishte qenë i bukur”.

Ku vallë kishte qenë kjo bukuri?

A kishte pasur me të vërtetë fëmijëri ky njeri?

Atij i mungonte tashmë kapelja karakteristike, dukej i çuditshëm në arkivol pa këtë kapele.

Kisha me vete një aparat fotografik dixhital dhe fiksova për herë të fundit, pamjen e tij.

Çuditërisht, kishte pamjen e një malësori dukagjinas, që janë rikthyer në origjinë, fytyra i ravijëzohej prej mustaqeve, por flokët e tij qenë pa asnjë thinjë.

Pak dashuri dhe kujdes më shumë, do të kishin bërë që miku im të jetonte shumë më gjatë sesa jetoi. Por ja që nuk ndodhi kështu. Në ka njeri që shpejtonte për të vdekur, në ka njeri që e kërkonte vdekjen pa pushim, ishte pikërisht Frederik Rreshpja. Tashmë, apelin e tij për të vdekur, ai e kishte realizuar qetësisht. Ceremonia e varrimit mbaroi, vëllezërit e tij Keli dhe Gjoni, së bashku me njerëzit e familjes, më vunë edhe mua në radhë së bashku me njerëzit e familjes, morën ngushëllimet e fundit dhe gjithçka mbaroi.

U varros njeriu më i madh i Shkodrës, një nga njerëzit më të shquar të Shqipërisë, rutina e varrimit nuk i përkiste më Frederik Rreshpes.

Ai u fut në dhe’ përfundimisht.

Dhe asnjë fuqi e epërme, nuk do ta nxirrte më jashtë thellësisë së dheut.

Mbidheu dhe qiejt, nuk kishin më rëndësi për të, as Hëna, as muzgjet dhe as përënditë ilire.

Ai nuk mund të shkruante vargje të pikëlluara për vetminë e tij, sepse tashmë ishte përfundimisht në thelbin e vetmisë më të madhe dhe më të pakthyeshme, që ishte vdekja.

Në një restorant të thjeshtë, u bë dreka mortore për të. Kisha ndjesinë e drekës mortore të nënës sime, të cilën Frederik Rreshpja e kishte njohur dhe kishte ngrënë bukë nga duart e saj. Frederik Rreshpja ishte një njeri i afërt i familjes sime.

I njihte të gjithë të afërmit e mi, madje kur vajza ime e vogël Kleitja takohej me të në fëmijërinë e saj, Frederik Rreshpja i thoshte: “A jemi shoqe?” – “Po” përgjigjej Kleitja. Kur vajza ime e madhe Arnisa, botoi në moshën 14-vjeçare librin e saj të parë me poezi, ishte pikërisht Frederik Rreshpja, që i bëri një Parafjalë të shkëlqyer, gjë që unë nuk mund ta harroj dot kurrë.

Në kujtesën time, seleksionoheshin vetëm motivet e paharrueshme, të ndritura, inkadeshente. Nuk kisha më fuqi të kujtoja çastet e hidhura dhe paradoksale.

Në drekën mortore, fola disa fjalë për Frederik Rreshpen. Thashë në substancë se “poet si Frederik Rreshpja, nuk mund të lindin thjesht për familjen e tyre, madje ata janë të pakuptueshëm për familjarët,

ata i përkasin një rendi tjetër, i përkasin një rendi transcendent, jo thjesht të kohës së tyre, madje edhe jo thjesht të kombit të tyre”.

Në kalendarin e Shkodrës dhe të Shqipërisë, dita e varrosjes së Frederik Rreshpes, nuk është një ditë e zakonshme.

Kishte vdekur poeti i madh.

Dhe kjo gjë ishte kuptuar fare pak.

Nuk ka pasur pas vdekjes së Migjenit, vdekje më të humneshme, sesa vdekja e Frederik Rreshpes.

Nuk kishte Frederik Rreshpja nevojë për Shkodrën, as për Shqipërinë, por e kundërta.

Ai ndoshta nuk i dha familjes së tij ndonjë gëzim të madh, sepse tërë fuqinë e mrekullisë njerëzore ia dha lirikës shqipe. Ishte pikërisht lirika shqipe, që kishte mbetur jetime. Ishte poezia shqipe, që duhej të vajtonte. Frederik Rreshpja kishte shkruar si Sokrati tek porta e vdekjes, pa frikë, madje me këmbëngulje e kishte kërkuar si një shpëtim, kapërcimin e kësaj porte. Mbasi për vite të tëra, i qe mohuar kjo kërkesë e çuditshme, më në fund e kishte arritur çastin e tmerrshëm dhe të pashmangshëm të kapërcimit të portës së vdekjes.

Po ç’është porta e vdekjes?

A ka kinse një portë të vdekjes, siç ka porta të dukshme të shtëpive dhe tempujve? Nuk e besoj.

Vdekja është një konveccion.

A është porta e vdekjes, diçka e lëndëshme, materiale, e prekshme, e ashpër, cinike, e pamëshirshme, e frikshme?

Për fat të mirë, porta e vdekjes nuk mund të shihet me sy. Ajo mund të kapërcehet, por jo duke e parë.

E ç’është vdekja?

Kush e sheh në fytyrë vdekjen?

Askush.

As Frederik Rreshpja nuk e pa dhe nuk dialogoi me sy, me sytë e vdekjes.

Vdekja është një aventurë, ose një shaka. Ajo nuk mund të frikësojë askënd.

Si mund ta ligëshmonte dhe ta sfiliste Frederik Rreshpen?

E ç’është vdekja përballë Frederik Rreshpes?

Çfarë targu ka ajo mbi të? Kjo gjë mund të kuptohet, por nuk mund të saktësohet kurrë. As unë nuk dua të bëj një apologji, ndonëse qartësia po më torturon, sepse vdekja e Frederik Rreshpes, është një nga momentet e vështira për mua. Ajo që është e pashmangshme, nuk ka përse të na trishtojë. Ajo që është për të gjithë ne, nuk ka përse të mitizohet. Mitet e Frederik Rreshpes, janë Poezia, por jo Vdekja.

Shënim i redaksisë: Poeti i madh, Frederik Rreshpja, me 23 mars 2017, me propozim të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, është dekoruar nga Presidenti i Republikës, Bujar Nishani, me titullin “Mjeshtër i Madh”.

REDAKSIA

Kryeredaktore: Suela Ndoja

Redaktorë: Luigj Shyti, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Kole Çardaku, Eilda Delija, Age Martini, Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj, Marijan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza e Ndue Ziçi.

Mundësoi Botimin:

**MARK MARAÇAJ
VILSON PESHKAJ
MIKEL KOPSAJ**